

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6092
E enjte, 20 gusht 2020
çmimi 0.40 €

Covid-19 në Kosovë: Edhe nëntë të vdekur dhe 162 raste të reja

FAQE 4-5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", ILIR IBRAHIMI | FAQE 4-5

NUK PRES MARRËVESHJE FINALE NGA TAKIMI I UASHINGTONIT



Analisti politik Ilir Ibrahim nuk pret ndonjë marrëveshje përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë në takimin e 2 shtatorit, i cili do të mbahet në Shtëpinë e Bardhë në Uashington. Në këtë intervistë dhënë për gazetën

"Epoka e re", ai ka thënë se në këtë takim mund të pritët vetëm ndonjë marrëveshje për çështje ekonomike si dhe arritje e ndonjë mirëkuptimi se çfarë pritët të arrihet me marrëveshjen përfundimtare. Ibrahim ka theksuar

se është shumë inkurajues fakti që ky takim organizohet nën ombrellën e Këshillit të Sigurisë Kombëtare të ShBA-ve. Ai ka theksuar se Qeveria e Kosovës duhet të ndërtojë një konsensus sa më të gjerë për dialogun

OPINION

KURRË NUK DO TË ARRIHET TË NJOLLOSET KOMBI YNË, KOSOVA KA HISTORI TË LAVDISHME (31) F. 11

Shkruan:
Kudusi LAMA



AKTUALE

NASER SAHITI ZGJEDHET REKTOR I UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS F. 6

BDI-ja NË QEVERINË E RE DO TË DREJTOJË GJASHTË MINISTRI F. 2



EKONOMI

MBI 2 000 FAMILJE PËRKRAHEN ME KUPONË PËR FURNIZIM ME GJËRA USHQIMORE DHE HIGJENIKE F. 8

QEVERIA PREMTON PËRKRAHJE PËR BIZNESET F. 9

SPORT

SHATRI: DËSHIRA ËSHTË E MADHE PËR TË PASUR SUKSES NË ARENËN NDËRKOMBËTARE

F. 16



DËSHTOJNË SEANCAT GJYQËSORE, ATO ONLINE VEÇ 'NË PLAN'



Në gjykatat e Kosovës një numër i madh i seancave nuk po mbahen ose edhe po dështojnë si pasojë e pandemisë. Aty po trajtohen vetëm rastet urgjente, kurse ende po punohet në

planin për kalimin e mbajtjes së seancave në formën online. Në këtë periudhë, sipas përfaqësuesve të shoqërisë civile, efikasiteti i punës ka rënë në masë të madhe | FAQE 7

KOSNETTI PËR RRUGËN DEÇAN - PLAVË: RESPEKTIMI I VENDIMIT TË GJYKATËS ÇON DREJT ZGJIDHJES SË VËRTETË | FAQE 5



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BDI-ja në qeverinë e re do të drejtojë gjashtë ministri

SHKUP, 19 GUSHT - Lidhja Socialdemokratike dhe Bashkimi Demokratik për Integrim kanë ndarë edhe postet ministore në kabinetin e ri qeveritar të Maqedonisë së Veriut, edhe pse këtë zyrtarisht nuk e kanë bërë ende me dije. Marrëveshja do të publikohet pasi që ndarja e resorëve dhe kuadrot që do t'i drejtojnë ato, t'i kalojnë në organet e partive.

Siç bëhet me dije nga përfaqësues të të dy partive politike, BDI-ja në kabinetin e ri do të drejtojë gjashtë ministri: Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Financave, Ekologjinë, Ekonominë, Sistemin politik dhe Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës Publike.

Lëvizja Besa, e cila ishte pjesë e koalicionit parazgjedhor me LSDM-në, do ta drejtojë Ministrinë e Bujqësisë, ndërsa resorët e tjerë si Ministrinë e Brendshme dhe të Mbrojtjes, të Punës dhe Politikës Sociale, të Arsimit, të Drejtësisë, Pushtetit Lokal, Transportit, Shëndetësisë dhe të Kulturës, do t'i takojnë LSDM-ja dhe partnerët e saj të koalicionit parazgjedhor. Nuk dihet nëse Partia Demokratike Shqiptare do ta ketë ndonjë post ministror, e cila, gjithashtu, do të jetë pjesë e qeverisë.

Se BDI-ja do ta ketë postin e Ministrisë së Jashtme, e ka konfirmuar edhe sekretari organizativ i kësaj partie, Artan Grubi, në një postim në llogarinë e vet në "Facebook". "Përveç kryeministrit, edhe tre ministra të jashtëm shqiptarë në rajon. Historike", ka shkruar Grubi.

Por, sipas marrëveshjes, kryeministër shqiptar do të ketë vetëm në fund të mandatit katërvjeçar, pra në 100 ditët e fundit të qeverisjes mes dy partive BDI dhe



LSDM.

Këtë e ka konfirmuar edhe një herë LSDM-ja përmes sekretarit të saj Lupço Nikollovski. "Gjatë formimit të koalicionit qeveritar ne insistuam të sigurojmë stabilitet në katër vjetët e ardhshëm. Sfidat janë të mëdha. Na pret shumë punë. Staf i ri duhet të sjellë vendime edhe më të forta përpara në të ardhmen evropiane të vendit, si dhe reforma vendimtare në luftën kundër korrupsionit dhe pastrimin e gjyqësorit. Zoran Zaev do të jetë kryeministër për katër vjetët e ardhshëm dhe së bashku me bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë do të bëjë çmos për t'i arritur të gjitha qëllimet strategjike", ka shkruar në "Facebook", Lupço Nikollovski, sekretar i

përgjithshëm i LSDM-së, që ka udhëhequr negociatat për formimin e qeverisë.

Opozita shqiptare e përbërë nga Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa, koalicionin e arritur e ka quajtur "koalicion të mashtrimit", ndërsa ka paralajmëruar fushatë për demaskimin e këtij mashtrimi dhe kthimin e legjitimitetit, pasi procesin zgjedhor e quan të manipuluar nga BDI-ja. "BDI-ja nuk ka aspak legjitimitet sepse e ka të blerë dhe të vjedhur, të shantazhuar dhe të frikësuar të qytetarëve. Por, edhe këtë shantazh të cilën e bëri ditën e zgjedhjeve, vazhdoi me të njëjtën logjik ta shantazhojë edhe veten me premtimin e rrejshëm për kryeministër shqiptar. Ne do të jemi këtu për t'i mbrojtur të drejtat e shqiptarëve, për t'u thënë atyre se mundet edhe

përtej mundësive, për t'u thënë oponentëve tanë se tani nuk do të kenë përballë vetëm parti politike të cilat dhunës së tyre do t'i përgjigjen me metoda demokratike. Por nëse është e nevojshme, ne së bashku me popullin do ta organizojmë edhe rezistencë për të mbrojtur lirinë, për ta mbrojtur verdiktin dhe ardhmërinë e të gjithë qytetarëve këtu në Maqedoni të Veriut", thuhet në reagimin e opozitës shqiptare.

Edhe opozita maqedonase që drejtohet nga VMRO-DPMNE-ja ka drejtuar kritika ndaj marrëveshjes LSDM-BDI. "Koalicioni LSDM-BDI nuk është për përparimin e vendit, por për vazhdimin e gënjeshtrave, krimin dhe korrupsionit. Ky koalicion është për vazhdimin e tenderëve të errët, shitjen e

interesave të shtetit në kurriz të pasurimit personal. Maqedonia nuk do ta shohë ringjalljen e premtuar, por ngecje, probleme dhe përçarje të thella. Zaev para zgjedhjeve tha për BDI-në se nuk vlen pesë para, kurse BDI për LSDM tha se ata janë kriminelë. Kështu që shteti do të ketë një qeveri kriminale që nuk vlen pesë para", ka deklaruar Dafina Stojanovska nga VMRO-DPMNE.

Qeveria e re pritet të votohet pasi që propozimet për ministrat të kalojnë në organet partiake të LSDM-së dhe BDI-së, ndërsa më pas do të caktohet edhe seanca e Kuvendit në të cilën do të zgjidhet edhe kryeparlamentari që, sipas Zoran Zaevit, në këtë post sërish do të jetë Talat Xhaferi nga BDI-ja.

Meta: Të mësojmë nga politika maqedonase dhe të kthehemi në shina sa më parë



TIRANË, 19 GUSHT (ER) - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka përshëndetur finalizimin e marrëveshjes historike në Maqedoninë e Veriut për formimin e qeverisë së re. Ai në një postim në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se finalizimi i marrëveshjes për formimin e qeverisë së re në Maqedoninë e Veriut është një

tjetër hap pozitiv për forcimin e institucioneve demokratike dhe përparimin e reformave. "Rritja e përfaqësimit të faktorit shqiptar në qeverisje, përfshirë dhe mundësinë e kryeministrit shqiptar në të ardhmen, është tregues evropianizues dhe vitalizues për forcimin e bashkëjetesës. Pas zgjedhjeve demokratike

dhe konkurrese, fqinji ynë ecën me siguri të merituar për çeljen e negociatave me Bashkimin Evropian. Duhet të mësojmë prej tyre dhe të kthehemi në shina sa më parë, duke nisur me respektimin e marrëveshjes së 5 qershorit dhe plotësimin e të gjitha kushteve të tjera", ka shkruar presidenti Meta.

Covid-19 në Kosovë: Edhe nëntë të vdekur dhe 162 raste të reja

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se gjatë 24 orëve të fundit kanë ndërruar jetë nëntë persona si pasojë e Covid-19, duke e çuar në 425 numrin e përgjithshëm të të vdekurve. Po ashtu, ky institut ka bërë me dije se brenda 24 orëve të fundit janë paraqitur edhe 162 raste të reja me koronavirus si dhe janë shëruar 122 persona. Sipas IKShPK-së, në Kosovë janë aktive edhe 3 739 raste me Covid, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarave ka shkuar në 7 684



EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 19 GUSHT - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 470 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 162 raste pozitive. Ky institut ka bërë me dije se brenda 24 orëve janë raportuar 9 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. "Numri total i rasteve pozitive është 11 848 raste nga 45 397 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 425 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 122 pacientë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 7 684 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 739", ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar se rastet e reja me Covid janë nga këto komuna të Kosovës: "Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 48 raste, komuna Pejë 21 raste, komuna Ferizaj 20 raste, komuna Vushtri 13 raste, komuna Mitrovicë 12 raste, komuna Fushë Kosovë 10 raste, komuna Prizren 5 raste, komuna Deçan 4 raste, komuna Gjakovë 4 raste, komuna Lipjan 4 raste, komuna Obiliq 4 raste, komuna Drenas 3 raste, komuna Klinë 3 raste, komuna Skenderaj 3 raste, komuna Kaçanik 2 raste,

komuna Podujevë 2 raste dhe me nga një rast komunat Istog, Malishevë, Rahovec dhe Suharekë", ka njoftuar IKShPK-ja.

FSK-ja vendos në dispozicion batalionin e mjekësisë në luftën kundër Covidit

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, të mërkurën është takuar me ministrin e FSK-së, Anton Quni, me të cilin ka diskutuar për mbështetjen dhe gatishmërinë e FSK-së për të kontribuar në luftën kundër pandemisë Covid-19. "Anton Quni më njoftoi se FSK-ja është në gatishmëri dhe ka kapacitete mjekësore e logjistike për të ndihmuar në çfarëdo situatë", ka shkruar Zemaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Më tutje, Zemaj ka bërë me dije se është vënë në gjendje gatishmërie edhe Batalioni i Mjekësisë në kuadër të FSK-së. "E falënderova z. Qunin për bashkëpunimin tonë dhe ndihmën e FSK-së që po e ofron në këtë betejë me Covid-19. I sqarova se Ministria e Shëndetësisë do ta përkrahë FSK-në me pajisje përkatëse mjekësore dhe për fuqizimin e personelit mjekësor. Me vajzat dhe djemtë e FSK-së dhe të gjithë qytetarët do ta mposhtim virusin", ka shkruar Zemaj. Po ashtu, Zemaj të mërkurën ka

vizituar Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), i cili është në vijën e parë të frontit në luftën kundër Covid-19. Gjatë kësaj vizite, Zemaj ka thënë se me drejtuesit e IKShPK-së ka biseduar në lidhje me mbarëvajtjen e punës në këtë institucion. "Sikurse edhe ekipi i

Labororit të Mikrobiologjisë Molekulare po bën testimet laboratorike me virus SARS-CoV-2 me metodën RT-PCR për qytetarët që mund të jenë të infektuar. Punonjësit aty janë duke u ballafaquar me ngarkesë të madhe të punës gjatë ditës. Sot vizitova IKShPK-në dhe takova

drejtorin Naser Ramadani, Xhevat Jakupi, drejtor i Labororit të Mikrobiologjisë Molekulare dhe Izet Sadiku, me të cilët biseduam rreth mbarëvajtjes së punës aty", ka shkruar Zemaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Humanizmit, ministri Zemaj ka thënë se mjekët dhe infermierët janë heronjtë e heshtur në këtë kohë të trazuar nga pandemia Covid-19. "Lufta e tyre është për jetën. Sot janë njerëzit më humanë. Personalisht sakrifikojnë, sepse këtë ua kërkon edhe profesioni që kanë zgjedhur. Janë heronjtë e heshtur në këtë kohë të trazuar nga pandemia Covid-19. E dimë se sa e rëndësishme është që në çaste të vështira të kemi pranë një mjek profesionist që të na lehtësojë dhimbjet. T'u shprehim mirënjohje për humanizmin dhe punën e tyre të palodhur që bëjnë çdo ditë. Ta nderojmë përgjegjësinë e tyre sociale për t'u shërbyer pacientëve dhe popullit", ka shkruar Zemaj.

47 pacientë me Covid në gjendje të rëndë shëndetësore

Qendra Klinike dhe Universitare të Kosovës (QKUK) ka bërë me dije se në këtë qendër dhe në spitalet e përgjithshme janë duke u trajtuar 533 pacientë, prej tyre 409 me Covid. Sipas QKUK-së, 47 pacientë me Covid janë në gjendje të rëndë. "533 pacientë janë duke u trajtuar në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe në spitalet e përgjithshme, prej tyre 409 janë të konfirmuar pozitivë me Covid-19. Me oksigjeno-terapi janë 348 persona, ndërsa 47 të tjerë janë në gjendje të rëndë shëndetësore. Në klinikat e QKUK-së janë të shtrirë për trajtim 205 pacientë, 170 të konfirmuar me Covid-19, gjersa 123 raste janë me oksigjeno-terapi. Spitalet e përgjithshme po ofrojnë shërbime mjekësore për 328 pacientë. 239 kanë rezultuar pozitivë, ndërkaq 225 persona i janë nënshtruar oksigjenoterapisë", ka njoftuar QKUK-ja.

Latif Gashi ftohet për intervistim nga Gjykata Speciale

PRISHTINË, 19 GUSHT (ER) - Ish-deputeti i PDK-së dhe ish-komandanti i Zonës Operative të Llapit, Latif Gashi, ka bërë me dije se është ftuar për intervistim nga Gjykata Speciale. Ai ka thënë se do t'i përgjigjet kësaj ftese për të dëshmuar se lufta e UÇK-së ka qenë e drejtë dhe e pastër. "Të nderuar bashkëluftëtarë, qytetarë, miq dhe familjarë, ju njoftoj se sot kam pranuar një thirrje telefonike nga një hetues për intervistim nga Gjykata



Speciale në Hagë. Ky intervistim do të bëhet më 27 gusht 2020. Si në shumë procese të deritanishme për liri dhe

pavarësi: Ilegalja e hershme, ilegalja dhe formimi i UÇK-së, lufta e UÇK-së. Procesin e pavarësisë dhe atë të

shtetndërtimit. Procese gjyqësore nga gjykata e UNMIK-ut, ai nga gjykata e EULEX-it, (gjithsej 16 vjet në shërbim të drejtësisë ndërkombëtare). Vetëm për të plotësuar standarde ndërkombëtare të pa drejta ndaj luftës së UÇK-së. Tani dhe kurdo qoftë, unë dhe bashkëluftëtarët e mi edhe këtë herë do të dëshmojmë se Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka qenë vendimtare e drejtë dhe do mbetet e tillë", ka thënë Gashi, duke shtuar se luftëtarët

e lirisë do të dalin faqebardhë edhe nga kjo betejë. "Triumfuam falë mbështetjes së popullit të Kosovës dhe jashtë saj, gjakut të dëshmorëve dhe ndihmesës së aleancës ndërkombëtare NATO të prira nga ShBA. Edhe kësaj radhe do të dalim faqebardhë, me dinjitet e krenar përjetësisht që kishim fatin ta ndërrojmë historinë nga robëria në liri...! Faleminderit për mbështetjen e vazhdueshme!", është shprehur Gashi.



Flet për “Epokën e re”, Ilir Ibrahim

Nuk pres marrëveshje finale nga takimi i Uashingtonit

Analisti politik Ilir Ibrahim nuk pret ndonjë marrëveshje përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë në takimin e 2 shtatorit, i cili do të mbahet në Shtëpinë e Bardhë në Uashington. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka thënë se në këtë takim mund të pritët vetëm ndonjë marrëveshje për çështje ekonomike si dhe arritje e ndonjë mirëkuptimi se çfarë pritët të arrihet me marrëveshjen përfundimtare. Ibrahim ka theksuar se është shumë inkurajues fakti që ky takim organizohet nën ombrellën e Këshillit të Sigurisë Kombëtare të ShBA-ve. Ai ka theksuar se Qeveria e Kosovës duhet të ndërtojë një konsensus sa më të gjerë për dialogun

marrëveshjeje. Shpresoj dhe besoj se ky takim do të krijojë momentumin e nevojshëm që Brukseli e Uashingtoni, të koordinuar, ta arrijnë pajtimin e dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë, përmes një marrëveshjeje për njohje të ndërsjellë”, ka thënë Ibrahim. Ibrahim ka deklaruar se spektri politik duhet të arrijë një konsensus për dialogun para këtij takimi. “Fatkeqësisht, spektri politik i Kosovës për një kohë të gjatë e ka shfrytëzuar çështjen e dialogut dhe çështje të tjera të politikës së jashtme për interesa të brendshme të luftës ndërpartiake. Qeveria e Kosovës duhet të ndërtojë një konsensus sa më të gjerë për dialogun. Fatkeqësisht, një gjë të tillë nuk po e shohim ende dhe kjo kam frikë se do të vazhdojë të na dëmtojë”, është shprehur Ibrahim.

një lloj pauze të angazhimit amerikan, është lajm i mirë që takimi do të ndodhë në shtator. Përveç peshës simbolike që ka një takim në Shtëpinë e Bardhë, është shumë inkurajues fakti që ky takim organizohet nën ombrellën e Këshillit të Sigurisë Kombëtare të ShBA-së dhe kjo duhet të mirëpritët dhe përshëndetet. Duke pasur parasysh të gjithë konstelacionin e zhvillimeve në Bruksel dhe Uashington, nuk pres që do të ketë ndonjë marrëveshje finale, por mund të presim ndonjë marrëveshje për çështje ekonomike si dhe arritje e ndonjë mirëkuptimi se çfarë pritët të arrihet me marrëveshjen përfundimtare. Presidenti Trump, tanimë përmes dy letrave drejtuar presidentëve të Kosovës dhe Serbisë, e ka bërë të qartë që marrëveshja përfundimtare duhet të çojë te një njohje e ndërsjellë. Ky është edhe një argument që ShBA-ja është e qartë në atë që pret nga dialogu, ndërkohë që Bashkimi Evropian vazhdon të jetë në amulli në qëndrimin e vet. →

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 19 GUSHT - Analisti politik Ilir Ibrahim ka bërë me dije se nuk pret që në takimin e 2 shtatorit në Uashington të arrihet ndonjë marrëveshje finale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ai ka deklaruar se ende nuk janë arritur kushtet për një gjë të tillë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka vlerësuar se inkurajues është fakti që ShBA-ja vazhdon të tregojë një interes për të qenë e kyçur në arritjen e një marrëveshje finale. “Unë nuk pres ndonjë marrëveshje

përfundimtare nga ky takim sepse nuk janë edhe kushtet për një gjë të tillë. Ajo që është inkurajuese, është fakti se ShBA-ja vazhdon të tregojë një interes për të qenë e kyçur në arritjen e një marrëveshjeje. Përvoja e deritanishme na tregon se pa një rol aktiv të ShBA-së gjërat në Ballkan nuk lëvizin”, ka thënë Ibrahim. Ai ka theksuar se është shumë inkurajues fakti që ky takim organizohet nën ombrellën e Këshillit të Sigurisë Kombëtare të ShBA-së. “Duke pasur parasysh të gjithë konstelacionin e zhvillimeve në Bruksel dhe Uashington, nuk

pres që do të ketë ndonjë marrëveshje finale, por mund të presim ndonjë marrëveshje për çështje ekonomike si dhe arritje të ndonjë mirëkuptimi se çfarë pritët të arrihet me marrëveshjen përfundimtare”, është shprehur Ibrahim. Sipas tij, kyçja e Uashingtonit në dialog tanimë ka ndikuar në procesin e Brukselit. Ai ka thënë se do të ketë një angazhim më të madh të Brukselit pas këtij angazhimi amerikan. “Unë vazhdoj të besoj, ashtu edhe siç na tregon historia, se Brukseli, i vetëm, pa një rol aktiv të Uashingtonit, nuk do të mund t’i çojë palët drejt një



ShBA-ja vazhdon të tregojë një interes për të qenë e kyçur në arritjen e një marrëveshjeje. Përvoja e deritanishme na tregon se pa një rol aktiv të ShBA-së gjërat në Ballkan nuk lëvizin. Me gjithë respektin për BE-në, struktura e fragmentuar dhe interesat e ndryshme të shteteve anëtare brenda kësaj organizate, e kanë bërë atë të paaftë për të pasur një qasje koherente në politikën e jashtme në përgjithësi dhe në qasjen ndaj Kosovës në veçanti.

“Epoka e re”: Mospajtimet e partnerëve të koalicionit qeverisës për procesin ekzistojnë. A është e gatshme Qeveria e Kosovës për këtë takim?

Ibrahimi: Mospajtimet e partnerëve të koalicionit nuk janë të shëndosha në procese të tilla, ku interesi vital i vendit është në pyetje. Fatkeqësisht, spektri politik i Kosovës për një kohë të gjatë e ka shfrytëzuar çështjen e dialogut dhe çështje të tjera të politikës së jashtme për interesa të brendshme të luftës ndërpartiake. Qeveria e Kosovës duhet të ndërtojë një konsensus sa më të gjerë për dialogun. Fatkeqësisht një gjë të tillë nuk po e shohim ende dhe kjo kam frikë do të vazhdojë të na dëmtojë.

“Epoka e re”: Përfaqësuesit institucionalë dhe politikë të Kosovës e kanë mirëpritur këtë takim, përveç Albin Kurtit, i cili e ka kritikuar takimin. Madje ai ka thënë se z. Grenell e do një sukses të orëve të fundit në politikën e jashtme. Si e keni parë qëndrimin e Kurtit?

Ibrahimi: Z. Kurti tanimë e ka përsëritur disa herë qëndrimin e vet ndaj iniciativës së ShBA-së dhe mendoj se është për të ardhur keq se si ai e ka humbur një mundësi për ta marrë përgjegjësinë që i takon dhe për të qenë pjesë e arritjes së një marrëveshje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në kohën sa ishte kryeministër. Argumentimi se ShBA-ja dëshiron një sukses në politikën e jashtme para zgjedhjeve presidenciale është qesharak. Nëse dikush mendon se në një kohë pandemie, krize ekonomike dhe sociale të paparë për dekada, marrëveshja Kosovë - Serbi do të ketë ndonjë rol në zgjedhjet presidenciale, është me të vërtetë amatore. Edhe në kohë normale politika e jashtme ka ndikim minimal në zgjedhje. Ky argumentim mund të përdoret për konsum të brendshëm, por asesi nuk është argument i bazuar.

“Epoka e re”: Mund ta presim arritjen e ndonjë marrëveshje nga ky takim?

Ibrahimi: Unë nuk pres ndonjë marrëveshje përfundimtare nga ky takim sepse nuk janë edhe kushtet për një gjë të tillë. Ajo që është inkurajuese, është fakti se

“Epoka e re”: Çfarë duhet të bëjë spektri politik i Kosovës para këtij takimi?

Ibrahimi: Spektri politik i Kosovës është i vetëdijshëm se dialogu me Serbinë është i një rëndësie nacionale. Këtë duhet ta dëshmojë edhe me veprime konkrete. Për çështje të interesit nacional nuk mund të ketë inate dhe teke personale, por të gjithë duhen bërë bashkë për ta çuar atë interes përpara. Nëse kemi arritur të bëhemi bashkë në kohë lufte, atëherë është pakuptueshme se si nuk arrijmë ta bëjmë një gjë të tillë sot kur jemi shtet i pavarur.

“Epoka e re”: Sa mund të ndikojë ky takim në procesin e dialogut të Brukselit?

Ibrahimi: Kyçja e Uashingtonit në dialog tanimë e ka ndikuar Brukselin. Ne kemi parë një angazhim më të madh të Brukselit pas këtij angazhimi amerikan. Ne koluare është thënë se kjo po bëhet nga frika se mos Uashingtoni po e merr primatin e dialogut. Unë vazhdoj të besoj, ashtu edhe siç na e tregon historia, se Brukseli i vetëm, pa një rol aktiv të Uashingtonit, nuk do të mund t'i çojë palët drejt një marrëveshjeje. Shpresoj dhe besoj se ky takim do ta krijojë momentumin e nevojshëm që Brukseli dhe Uashingtoni të koordinuar, ta arrijnë pajtimin e dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë, përmes një marrëveshjeje për njohje të ndërsjellë.

Kosnetti për rrugën Deçan - Plavë: Respektimi i vendimit të gjykatës çon drejt zgjidhjes së vërtetë



**EPOKA
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 19 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur të mërkurën në takim kryetarin e Deçanit, Bashkim Ramosaj, me të cilin ka biseduar në lidhje me rrugën Deçan - Plavë, e cila kalon kah Manastiri i Deçanit. Hoti ka ritheksuar se duhet të respektohet legjislacioni në fuqi i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. “Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar t’i përkrahë komunat e vendit për realizimin e projekteve të tyre zhvillimore. Duke e vlerësuar edhe një herë rëndësinë e rrugës që lidh Deçanin me Plavën, përkatësisht Republikën e Kosovës me Republikën e Malit të Zi, sot, në takim me kryetarin e Deçanit, Bashkim Ramosaj, ritheksova se duhet të respektohet legjislacioni në fuqi i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, po ashtu duhet të kihet parasysh edhe rëndësia e kësaj rruge për ekonominë dhe

cilësinë e jetës së banorëve të Komunës së Deçanit dhe më gjerë. Me qëllim të gjetjes së një zgjidhjeje të pajtueshme me të gjitha palët e përfshira në këtë çështje, u morëm vesh që të pezullohen punimet në rrugën R108, e cila përshkon një pjesë të zonës së mbrojtur pranë Manastirit të Deçanit”, ka thënë Hoti pas takimit me Ramosajn. Ndërsa kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka bërë me dije se i ka dhënë afat Hotit për të gjetur zgjidhje për ndërtimin e kësaj rruge. “Pas temave të ngritura, Deçani ka filluar ta ketë vëmendjen e duhur! Kam zhvilluar takim me kryeministrin Hoti. Jam marrë vesh t’i jap afatin e arsyeshëm që ta bëjë zgjidhjen e kontestit për ndërtimin e rrugës”, ka thënë Ramosaj. Ambasadori amerikan në Prishtinë, Philip Kosnett, ka përgëzuar takimin në mes të kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti dhe kryetarit të Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, të cilët janë pajtuar për pezullim të punimeve në rrugën Deçan-Plavë.

“Ndërtimi i autostradës Deçan - Plavë ka të bëjë me shumë sesa me tokën dhe qasjen. Ka të bëjë me zbatimin e vendimeve të gjykatës, respektimin dhe ruajtjen e të drejtave të të gjithëve për t’i praktikuar besimet e tyre, për të jetuar në paqe me fqinjët dhe për ta vlerësuar trashëgiminë e pasur të Kosovës dhe diversitetin e saj kulturor”, ka thënë Kosnett në një shkrim publikuar në rrjetin social në “Twitter”. Gjykata Kushtetuese e Kosovës më 2016 kishte marrë vendim, sipas të cilit, Manastirit të Deçanit i njihet e drejta e pronësisë për 24 hektarë tokë. Por, ky vendim nuk është zbatuar asnjëherë nga ana e kësaj komune. Zyrtarë të institucioneve ndërkombëtare në Kosovë në vazhdimësi kanë bërë thirrje që të respektohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese. “Bashkëpunimi dhe përkushtimi për të gjetur zgjidhje që respekton vendimin e gjykatës është rruga e vetme që çon drejt zgjidhjes së vërtetë”, ka shtuar ambasadori amerikan.

Kryeministri shërohet plotësisht nga Covid-19, kthehet në punë



PRISHTINË, 19 GUSHT (ER) - Kryeministri i vendit, Avdullah Hoti, pas dy javësh trajtim mjekësor dhe në izolim, të mërkurën u është kthyer detyrave në zyrë, i shëruar plotësisht nga Covid-19. Lajmin për kthimin në punë Hoti e ka bërë përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook". "Bashkëndiej dhe u dëshiroj shërim të shpejtë të

gjithë të prekurve. Shfrytëzoj rastin që t'ju bëj thirrje sërish, të jemi të kujdesshëm dhe t'i respektojmë në përpikëri masat për mbrojtje nga Covid-19. Ka ende qytetarë që nuk besojnë se virusi ekziston dhe kjo është shqetësuese. Numri i rasteve me të infektuar dhe viktima vazhdon të jetë i lartë, prandaj derisa të zbulohet vaksina, ne duhet të tregojmë kujdes të shtuar", ka shkruar Hoti.

Kryeministri ka pohuar se bashkë me kabinetin e tij janë të vendosur më shumë se kurrë që ta shtyjnë përpara agjendën e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe t'u qëndrojnë pranë qytetarëve dhe bizneseve në ballafaqimin me pasojat e shkaktuara nga pandemia.

Naser Sahiti zgjedhet rektor i Universitetit të Prishtinës

PRISHTINË, 19 GUSHT (ER) - Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" ka zgjedhur rektor prof. dr. Naser Sahitin. I njëjti është zgjedhur me shtatë vota nga nëntë sa ka gjithsej Këshilli Drejtues i UP-së. Dy vota të tjera i ka marrë prof. dr. Faton Berisha, ndërsa prof. dr. Blerim Rexha asnjë votë. Me këtë rast, rektori i ri i Universitetit të Prishtinës, Naser Sahiti, ka thënë se përmirësimi i mësimdhënies dhe infrastrukturës në UP do të jetë prioritet i tij. Sahiti ka theksuar se nuk do të lejojë që të ketë ndikime politike në UP. "Rektori duhet të jetë rektor që t'u qëndrojnë mbrapa interesave të studentëve dhe sigurisht do t'i

evitohet të gjitha ndikimet e mundshme në vendimmarrjet e mia, me qëllim që mos të pengohet procesi që është i zakonshëm dhe që është në dobi të studentëve", ka thënë Sahiti, duke u zotuar se do të punojë brenda kornizave ligjore. "Për ekipin kam menduar dhe nuk është çështje e kryer. Ende jam në konsultime dhe nuk ka emra të cilët mund të përfshihen nga jashtë. Unë do të punoj brenda kornizës ligjore që ekziston dhe brenda kornizave të tilla çdo bashkëpunim legal do ta përkrah dhe asnjë ndërhyrje nga jashtë nuk do të lejohet nga unë dhe vendimmarrja nuk do të ndikohet nga politika", është shprehur Sahiti.



Komuna e Gjakovës ndan 12 hektarë tokë për "Fehmi Aganin"



GJAKOVË, 19 GUSHT (ER) - Rektori i Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", Artan Nimani, është pritur të mërkurën në takim nga kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini. Rektori Nimani e ka informuar kryetarin Gjini për hapat e ndërmarë në fillimin e vitit të ri

akademik si dhe për procedurat e fillimit të punimeve për ndërtimin e kompleksit të ri universitar "Fehmi Agani". Kryetari Gjini e ka përgëzuar rektorin Nimani për zhvillimin dhe për avancimin e komponentit arsimor të Universitetit të Gjakovës "Fehmi

Agani", njëherësh i ka ofruar mbështetjen e nevojshme për ngritjen institucionale. Komuna e Gjakovës ka ndarë 12.8 hektarë tokë për kompleksin e ri "Fehmi Agani" dhe ka aprovuar lejet e nevojshme për fillimin e ndërtimit të këtij kompleksi.

Osmani merr pjesë në forumin ndërkombëtar të liderëve

Ky forum ndërkombëtar po organizohet përgjatë javës së Konventës së Partisë Demokratike në ShBA, nga 17-21 gusht

PRISHTINË, 19 GUSHT (ER) - Me ftesë të Institutit Nacional për Demokraci (NDI) të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu, mori pjesë në Forumin Ndërkombëtar të Liderëve, i cili sivjet u organizua virtualisht për shkak të pandemisë Covid-19. Ky forum ndërkombëtar po organizohet përgjatë javës së Konventës së Partisë Demokratike, nga 17-21 gusht.

Gjatë këtyre ditëve, kur janë ftuar liderë institucionesh dhe partish politike nga vende të ndryshme të botës, pjesëmarrësve u drejtohen figura të rëndësishme të politikës amerikane, gazetarë, ekspertë dhe komentatorë, për të diskutuar tema të zhvillimeve politike kombëtare dhe ndërkombëtare. Sivjet temat kanë përfshirë rolin e ShBA-së në politikën e jashtme, avancimin e rolit të gruas në politikë dhe vendimmarrje, mbrojtjen e demokracisë nga

dezinformatat etj. NDI ka ftuar liderë ndërkombëtarë për këtë forum që nga viti 1984. Sivjet forumi është hapur nga ish-sekretarja e Shtetit, Madeleine Albright, e cila e udhëheqë NDI-në. Kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani-Sadriu, ka falënderuar Institutin Nacional për Demokraci dhe presidentin e saj, Derek Mitchell, për ftesën, si dhe ka vlerësuar rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në veçanti rolin kyç që ka luajtur NDI për avancimin e demokracisë në Kosovë.



Dështojnë seancat gjyqësore, ato online veç 'në plan'

PRISHTINË, 19 GUSHT - Në gjykatat e Kosovës një numër i madh i seancave nuk po mbahen ose edhe po dështojnë si pasojë e pandemisë. Aty po trajtohen vetëm rastet urgjente, kurse ende po punohet në planin për kalimin e mbajtjes së seancave në formën online. Në këtë periudhë, sipas përfaqësuesve të shoqërisë civile, efikasiteti i punës ka rënë në masë të madhe.

Në Këshillin Gjyqësor të Kosovës thonë se aktualisht gjykatat e Kosovës punojnë me kapacitete të limituara për shkak të pandemisë, por edhe për shkak të pushimeve verore. "Kemi vështirësi shumë. Ka shumë seanca që po dështojnë për shkak të pandemisë. Në seanca nuk paraqiten dëshmitarë, nuk paraqiten mbrojtësit e të akuzuarve...", ka thënë kryesuesi i këtij këshilli, Skënder Çoçaj.

Ai ka shtuar se momentalisht punohet vetëm me lëndë të caktuara dhe që janë më urgjente. "Fokusi kryesor është të lëndët me parburgim, të lëndët e shënjestruara, të lëndët që janë në rrezik që ta kalojnë afatin prej tre muajsh, siç janë lëndët penale dhe rastet e dhunës në familje", ka deklaruar Çoçaj.

Edhe kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Bahri Hyseni, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se po punohet me staf të reduktuar, por po përpiqen që të mos dështojnë seancat e rasteve urgjente. "Po punohet sidomos për rastet që kanë të bëjnë me parburgim ose rastet që kanë të bëjnë me shkeljet e detyrave zyrtare", ka thënë Hyseni.



IKD: Gjyqtarët po dështojnë t'i administrojnë seancat

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) vlerëson se që nga marsi i këtij viti kur në Kosovë u paraqitën rastet e para me koronavirus, efikasiteti i punës në sistemin e drejtësisë ka rënë në masë të madhe. Drejtori i IKD-së, Ehat Miftaraj, thotë se jo rrallëherë gjyqtarët nuk ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësit e tyre në raport me prokurorët dhe avokatët apo edhe palët e tjera në procedurat gjyqësore. "Gjyqtarët nuk janë në gjendje t'i kontrollojnë dhe të administrojnë seancat gjyqësore dhe jo rrallëherë vjen edhe deri te shtyrja e seancave gjyqësore. Në bazë të Kodit Penal dhe ligjeve të tjera që rregullojnë çështjet civile dhe administra-

tive, gjyqtarët mund të shqiptojnë gjopa, mund të marrin masa ndaj prokurorëve dhe palëve në procedurë nëse nuk e respektojnë autoritetin e gjykatës. Fatkeqësisht gjyqtarët këtë të drejtë nuk e zbatojnë në praktikë asnjëherë, e që ndikon në uljen e autoritetit të tyre, e me këtë edhe në mosmenaxhimin e duhur të seancave gjyqësore", ka deklaruar Miftaraj.

Ndërkaq kryetari i Odës së Avokatëve të Kosovës, Behar Ejupi, ka pohuar se avokatët aktualisht kanë vështirësi të mëdha në ushtrimin e profesionit të tyre për shkak të pandemisë së koronavirusit. Ai ka thënë se puna e avokatëve është e lidhur ngushtë me punën e gjykatave dhe prokurorive dhe se, sipas tij, seancat në gjykata nuk janë duke dështuar për shkak të mospranisë së avokatëve. "Oda

e Avokatëve në anëtarësi të vet ka mbi 1 080 avokatë. Kështu që, sa iu përket avokatëve, nuk shtyhen seancat, mirëpo seancat shtyhet për shkak të vendimeve që kanë marrë Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial. Kemi kërkuar që të krijohen kushte për mbajtjen e seancave ashtu siç janë edhe rekomandimet e institutit [IKShPK-së], me qëllim që të ruhet shëndeti dhe të mos bëhet shkelje e të drejtave dhe lirive të personave të cilët janë në procedurë, e që kanë nevojë edhe për avokat", ka thënë Ejupi.

Seancat online, në pritje të planit

Drejtesit e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe atij Gjyqësor thanë për "Radion Evropa e Lirë" se ende janë duke punuar rreth planit për

fillimin e mbajtjes së seancave gjyqësore në formën online, por diçka e tillë nuk ka nisur ende.

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor, Skënder Çoçaj, thotë se për mbajtjen e seancave online po shikohen në radhë të parë aspektet ligjore dhe ato teknike. "Duhet të ketë gatishmëri edhe nga të gjitha palët që të marrin pjesë në seanca online. Ne jemi në diskutime me Këshillin Prokurorial, me Prokurorin e Shtetit, me Odën e Avokatëve në mënyrë që të organizohemi që qysh nga shtatori... nuk po them menjëherë sepse tash shtatori gati erdhi, por në shtator do të fillojmë me seanca gjyqësore online", ka thënë Çoçaj.

Zyrtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës kanë thënë se grumbullimi i lëndëve të pazgjidhura vazhdon të jetë problem, i cili gjyqësorin po e përcjellë në vazhdimësi për dy dekada.

Në një raport të Këshillit Prokurorial të Kosovës thuhet se nga gjithsej 806 prokurorë e staf administrativ, 68 persona kanë qenë të infektuar me koronavirus, kurse deri në fundjavën e kaluar, 23 nga ta vazhdojnë të jenë ende pozitivë me koronavirus.

Prokuroritë e Kosovës aktualisht po punojnë me staf të angazhuar deri në 40 për qind, të cilët janë me punë në zyrë, kurse pjesa tjetër punon nga shtëpitë. Ndërkaq, sipas të dhënave nga Këshilli Gjyqësor, aktualisht 32 persona, zyrtarë ligjorë dhe gjyqtarë janë të infektuar me koronavirus, ndërsa 4 të tjera janë në vetizolim pasi kanë pasur kontakte me persona të infektuar.

Haziri e Arifi koordinohen për bashkëpunim në të mirë të dy komunave

GJILAN, 19 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur të mërkurën në takim kryetarin e rizgjedhur të Komunës së Bujanocit, Nagip Arifi.

Haziri, me këtë rast, pasi e ka uruar për rizgjedhje, ka thënë se kryetari Arifi si udhëheqës politik ka punuar shumë për të ndërtuar një kulturë bashkëpunimi e uniteti edhe në garën për parlament, por edhe në koalicionin paszgjedhor në Bujanoc. "E urova mikun tim, Nagip Arifi, për rikthimin në krye të Bujanocit, pas zgjedhjeve të lira. Shpresoj se shumë shpejt do të koordinohet edhe vizita kthyesë. Biseduam për çështjet që lidhen me interes të përbashkët sepse jemi territor, vend dhe familje të pashkëputura mes njëri-tjetrit. Kufirin që e kemi po përpiqemi që ta zbusim për

qarkullimin e mallrave dhe të njerëzve deri në një zgjidhje përfundimtare", ka thënë Haziri.

Kurse kryetari Nagip Arifi, pasi e ka falënderuar kryetarin Haziri për pritjen, ka theksuar se në Bujanoc është bërë koalicioni gjithëshqiptar, i cili, sipas tij, është model që të përdoret edhe në Malin e Zi e Maqedoni. "Është vizita e parë e imja që e bëj jashtë Bujanocit, pikërisht në Gjilan, sepse z. Haziri është miku im i vjetër. Biseduam edhe për menaxhimin e situatës së pandemisë dhe në të ardhmen do të bashkëpunojmë edhe në sfera të tjera. Nuk është vizita as e parë e as e fundit. Ne do të jemi në Gjilan që të shkëmbejmë mendime dhe të punojmë edhe për të zhvendosurit nga Malësia në këtë komunë", ka thënë Arifi.



Mbi 2 000 familje përkrahen me kuponë për furnizim me gjëra ushqimore dhe higjienike

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 19 GUSHT - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, bashkë me menaxheren e Portofolit për Zhvillim të Qëndrueshëm në UNDP, Shkipe Deda-Gjurgjiali, të mërkurën kanë shpërndarë kuponë për mbështetjen e mbi 2 000 familje të cenueshme që jetojnë në varfëri ekstreme që do të përdoren për 3 muaj për furnizim me gjëra ushqimore, higjienë dhe sende të tjera të domosdoshme. Kjo mbështetje, që zbatohet për herë të parë në Kosovë, realizohet përmes përkrahjes së drejtpërdrejtë financiare nga Qeveria e Dukatës së Madhe të Luksemburgut dhe u dedikohet familjeve me kushte të vështira, kryesisht atyre me vetëm një prind dhe familjeve të tjera në situata të cenueshme.

Ministri i MPMS-së, Skender Reçica, ka thënë se në këtë situatë të vështirë pandemike, t'i ndihmohet familjet nga grupet e cenueshme përfituese të asistencës sociale, tregon më së miri gjithë angazhimin dhe zotimin tonë si MPMS-së, për të qenë pranë qytetarëve që kanë nevojë për t'u dhënë një dorë mbështetjeje.

Ministri Reçica ka falënderuar dhe ka shprehur mirënjohje për qeverinë e Dukatës së Madhe të

Luksemburgut për mbështetjen financiare dhe UNDP-në për zbatimin e skemës për ta mbështetur sa më shumë përbushjen e nevojave të grupeve të cenueshme. Gjithashtu, ministri Reçica ka thënë se si ministër i MPMS-së është shumë i lumtur që ka sadopak mundësi për t'u gjendur afër këtyre familjeve. "Angazhimi im për përmirësimin e jetës dhe mirëqenies së qytetarëve nuk do të mungojë asnjëherë", ka thënë ai.

Ndërsa Shkipe Deda-Gjurgjiali nga UNDP ka theksuar se me anë të kësaj skeme këtyre 2 000 familjeve të përzgjedhura po ua japin mundësinë për t'i blerë gjërat e domosdoshme që u duhen më shumë dhe që nuk u janë siguruar përmes ndihmave tjera humanitare.

Programi i skemës me Kartela/kuponë synon që familjet t'i ndaj në tri grupe dhe t'i përkrahë financiarisht secilin muaj gjatë periudhës tremujore me vlera të ndryshme si: Familjet deri në 1-4 anëtarë me 180 euro për 3 muaj (60x3); Familjet me 5-7 anëtarë me 210 euro për 3 muaj (70x3); dhe Familjet mbi 8 anëtarë me 240 euro për 3 muaj (80x3).

Grupet kryesore të përfituesve do të jenë familjet pa të ardhura, familjet me vetëm një prind, familjet me persona me nevoja



të veçanta dhe familjet e varfra që jetojnë në zona rurale.

Identifikimi i familjeve të pranueshme do të bëhet në koordinim të ngushtë me Qendrat për Punë Sociale. Ato që do të përzgjidhen duhet t'i plotësojnë disa kushte të veçanta krahas atyre të përgjithshme ku fillimisht të gjitha familjet duhet të jenë përfituese të skemës së ndihmës sociale qoftë nga kategoria e parë apo e dytë dhe t'i takojnë njëres prej kategorive

si më poshtë:

- Prind vetushqyes, me theks nënat vetushqyese
- Familjet të cilat e kanë problemin e banimit të pazgjedhur
- Familjet të cilat kanë persona të sëmurë dhe me paaftësi brenda familjes
- Familjet me më shumë fëmijë në shkollë
- Familjet nga zonat e thella rurale të cilat kanë vështirësi në tregun e punës

- Familjet e minoriteteve në gjendje të rëndë socio-ekonomike Ky donacion u siguroi si pjesë e përgjigjes së menjëhershme ndaj Covid-19 në kuadër të projektit Zbutja e Ndikimit të Krizës Humanitare dhe në Shëndet si dhe Mbrojtja Themelore Sociale për Grupet më të Cenueshme, të financuar nga Qeveria e Dukatës së Madhe të Luksemburgut, përmes LuxDev, në një shumë të përgjithshme prej një milion eurosh.

Rukiqi viziton 'ABI Progres-in': Fuqizimi i prodhimit vendor, shtylla kryesore e rimëkëmbjes së ekonomisë

Kompania 'ABI Progres', pavarësisht grumbullimit të stoqeve dhe vështirësive në plasimin e produkteve finale, për shkak të rënies së kërkesës në tregje, si pasojë e pandemisë Covid-19, edhe këtë vit ka vendosur të grumbullojë, pa asnjë kufizim, të gjitha produktet e kultivuara nga fermerët dhe bujqit e vendit tonë

PRISHTINË, 19 GUSHT (ER) - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka vizituar të mërkurën kompaninë 'ABI Progres', për ta parë nga afër aktivitetin e grumbullimit të produkteve sezonale nga fermerët dhe bujqit.

Kompania 'ABI Progres', pavarësisht grumbullimit të stoqeve dhe vështirësive në plasimin e produkteve finale, për shkak të rënies së kërkesës në tregje, si pasojë e pandemisë Covid-19, edhe këtë vit ka vendosur të grumbullojë, pa asnjë kufizim, të gjitha produktet e kultivuara

nga fermerët dhe bujqit e vendit tonë, në mënyrë që t'u ndihmohet kategorive më të rëndësishme për mirëqenien e familjeve tona.

Rukiqi ka thënë se përkrahja për fermerët dhe bujqit nga kompanitë tona vendore nga kompania 'ABI Progres' dhe pronari i saj Irfan Fusha është shembulli më i mirë i promovimit të zinxhirit të zhvillimit dhe promovimit të produkteve vendore por, sipas tij, ky zinxhir mund të bëhet i qëndrueshëm dhe shtyllë e zhvillimit të vendit vetëm me përkrahje efikase dhe mirë



të dizajnuar përmes politikave publike dhe përkrahjes financiare adekuate nga buxheti i vendit. Ai ka thënë se fuqizimi i kompanive vendore dhe pro-

movimi i produkteve vendore duhet të jetë shtylla kryesore e programit të rimëkëmbjes ekonomike.

Rukiqi do t'i vazhdojë vizitat

edhe në kompani të tjera për ta ngritur vëmendjen për nevojën e përkrahjes së fuqishme institucionale për rimëkëmbjen ekonomike.

Qeveria premton përkrahje për bizneset

Zëvendëskryeministrja Albulena Balaj-Halimaj dhe ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, në vizitën që patën në Zonën Ekonomike të Suharekës, kanë premtuar përkrahjen e qeverisë për këtë zonë ekonomike



**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 19 GUSHT - Zëvendëskryeministrja Albulena Balaj-Halimaj dhe ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, të shoqëruar nga kryetari i kësaj komune, Bali Muharremaj, kanë vizituar Zonën Ekonomike të Suharekës.

Zëvendëskryeministrja Albulena Balaj-Halimaj dhe ministri i Tregtisë, Vesel Krasniqi, u njoftuan nga afër me punën dhe problemet që ballafaqohet Komuna e Suharekës.

Kryetari i Suharekës, Bali Muharremaj, ka thënë se kjo zonë është me rëndësi të veçantë pasi që këtu janë 1 000 të punësuar dhe pretendimet janë që të rritet numri i punëtorëve. “Jemi në unazën e majtë, e cila e shkarkon qytetin tonë. Patëm nderin që ta vizitojmë edhe zonën industriale ku

jemi para përfundimit të punimeve. Është një projekt shumë me rëndësi për qytetarët e komunës sonë. Vlera është 2.5 milionë euro. Besoj se, sipas informatave që morëm prej zëvendëskryeminstres dhe ministrit, është në plan dinamik, që të përfundojë këtë vit. Është në interes për arsye se në këtë zonë industriale janë rreth 1 000 punëtorë dhe pretendimet tona janë që të vazhdojmë që të rritet numri i punëtorëve. Po ashtu, edhe kjo rrugë ka rëndësi shumë të veçantë për qytetarët tanë, që të shkarkohet qyteti dhe qytetarët të kalojnë me lirshëm, pra që t'i kryejnë obligimet e veta”, ka thënë Muharremaj.

Ndërsa zëvendëskryeministrja Balaj-Halimaj ka thënë se qëllimi i kësaj vizite është t'u ofrojnë mbështetje kompanive që operojnë në këtë Zonë Ekonomike. Ajo ka thënë se qeveria është e përkushtuar që t'i mbështesë bizneset vendore.

“Bashkë me ministrin Krasniqi dhe kryetarin Muharremaj kemi dashur ta shohim nga afër funksionimin e bizneseve, sidomos në këtë kohë të pandemisë. Jemi këtu për ta dhënë mbështetjen e plotë ashtu siç ua kemi dhënë edhe qeverive të kaluara, ku në këtë pjesë janë investuar 2.5 milionë euro. Do t'i vazhdojmë investimet”, ka thënë Balaj. Ajo ka shtuar se kjo

është ndër zonat model jo vetëm në Republikën e Kosovës, por edhe në regjion prandaj, sipas saj, qeveria është e interesuar, përveç punimeve këtu, t'i ndihmojë bizneset me masa konkrete.

Edhe ministri Krasniqi ka thënë se këto punime do të jenë ndihmë e madhe për këto biznese si dhe për të tjerat që do të ndërtohen, duke veçuar se

gradualisht po kompletohet kjo Zonë Ekonomike. “E pamë nga afër se shumë biznese, diku rreth 50 sosh, veçse ushtrojnë veprimtarinë në këtë zonë”, ka thënë Krasniqi. Kjo unazë që pretendohet se do ta zhblllokojë dukshëm komunikacionin rrugor do të kushtojë 2.5 milionë euro, ndërsa punimet pritet të përfundojnë deri në fund të këtij viti.

Zemaj takohet me gastronomët, bisedohet për masat e reja



PRISHTINË, 19 GUSHT (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka takuar të mërkurën përfaqësuesit e Shoqatës së Gastronomëve të Kosovës. Ai ka bërë me dije se me gastronomët ka biseduar për masat e reja që do të merren nga qeveria në ditët e ardhshme. Sipas tij, gastronomët janë pajtuar për zbatimin e rregullave për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19. “Me përfaqësuesit e Shoqatës së Gastronomëve, Petrit Kllokoqi dhe gastronomë nga qytete të ndryshme të Kosovës, bisedova për masat e reja që do të merren nga qeveria në ditët në vijim. U pajtuam se

të gjithë së bashku duhet t'i zbatohet rregullat për ta parandaluar përhapjen e virusit sikurse dhe udhëzimet që dalin nga Manuali për Mbrojtje nga Përhapja e Covid-19. Jemi të vetëdijshëm se pandemia nuk po e dëmton vetëm shëndetin tonë, por ka shkaktuar dëme të mëdha edhe në ekonomi dhe po rrezikon funksionimin e bizneseve. Po ashtu, po e cenon edhe mbijetesën ekonomike të shumë familjeve. Sqarova se jam i gatshëm që në çdo çast t'i takoj përfaqësuesit e bizneseve dhe këta t'i shohin nga afër angazhimet tona në luftën kundër virusit”, ka thënë Zemaj pas takimit me gastronomët.

Diskutohet për masat e uljes së shumimit të qenve endacakë në Kosovë

PRISHTINË, 19 GUSHT (ER) - Zëvendëskryeministri Besnik Tahiri së bashku me ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, kanë takuar të mërkurën përfaqësuesit e Fondacionit për të Drejtat e

Kafshëve, përfaqësuesin nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës, Lahi Brahimaj, si dhe drejtorin e Drejtorisë për Mirëqenien e Kafshëve, Sadik Heta, me të cilët kanë diskutuar rreth masave të uljes së shumimit të

qenve endacakë në Kosovë. “Vendosëm që të finalizohen amendamentimet ligjore me qëllim që të fillojë regjistrimi i kafshëve shoqëruese, në mënyrë që mbajtësit e qenve dhe mbarështuesit të regjistrohen dhe puna e tyre të

monitorohet. Qentë endacakë burojnë nga qentë me mbajtës (pronarë) dhe ne duhet të punojmë përmbajtësisht që ky problem të zgjidhet në mënyrë të qëndrueshme”, ka thënë zëvendëskryeministri Besnik Tahiri pas takimit.



Ndërpritet protesta e transportuesve në Gjilan, fillon puna në të gjitha vijat e mëhershme

GJILAN, 19 GUSHT (ER) - Komuna e Gjilanit ka njoftuar se transportuesit publikë të udhëtarëve kanë ndërprerë protestën dhe kanë filluar punën, duke ofruar shërbime për qytetarët e Gjilanit me rrethinë në të gjitha vijat që ishin pezulluar më parë. Drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik në Gjilan, Valbona Tahiri, ka bërë me dije se në takimin e përbashkët me Shoqatën e Transportuesve "Anamorava" dhe menaxhmentin e NPL "Stacioni i Autobusëve", është arritur mirëkuptim për vazhdimin e marrëveshjes bazë të nënshkruar me Shoqatën e Transportuesve "Anamorava" për lirim prej 50-përqindësh për peron deri më 15 shtator 2020 dhe largimin e taksistëve ilegalë.

respektivisht Drejtoria e Inspeksionit dhe inspektorët komunalë, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës do t'i shtojnë aktivitetet për mbikëqyrjen në kuadër të kompetencave ligjore dhe përgjegjësi që t'i vazhdojnë aktivitetet e rregullta në terren për ta parandaluar operimin e taksive ilegale. Me qëllim të mbështetjes së sektorit privat, për tejkalimin e krizës së shkaktuar nga virusi "Korona", kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, brenda kapaciteteve dhe kompetencave ka marrë masa lehtësuese për bizneset dhe është duke bërë përpjekje të vazhdueshme për tejkalimin e krizës, duke ndikuar edhe në sektorin publik, pasi janë kufizuar mundësitë për realizimin e investimeve kapitale publike.



KFOR-i amerikan dhuron donacion dhjetë shtretër për QKMF-në në Kamenicë

KAMENICË, 19 GUSHT (ER) - Donacionet në Komunën e Kamenicës janë të shpeshta. Kësaj radhe KFOR-i amerikan së bashku me Njësitin për Ndërlidhje dhe Monitorim kanë dhuruar dhjetë shtretër për Qendrën Kryesore të Mjekësisë

Familjare (QKMF) në Kamenicë. Këta shtretër kanë ardhur si kërkesë e drejtoreshës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Suna Zajmi-Krasniqi. "Para disa ditësh kam bërë kërkesë për disa shtretër dhe menjëherë KFOR-i

amerikan i është përgjigjur kërkesës sime, ku ka dhuruar dhjetë shtretër. E falënderoj shumë për këtë donacion dhe për bashkëpunimin që ka me ne", ka thënë ajo, duke theksuar se këta shtretër ishin të nevojshëm për QKMF-në.

Komuna e Skenderajt bëhet me E-kiosk për pajisje me çertifikata të gjendjes civile

SKENDERAJ, 19 GUSHT (ER) - Tani e tutje nuk do të ketë më radhë të pritjes nga qytetarët për t'u pajisur me çertifikata të gjendjes civile në Komunën e Skenderajt. Kryetari i kësaj komune, Bekim Jashari, së bashku me drejtoreshën e Administratës, Emine Rrecaj dhe udhëheqësin e sektorit të gjendjes civile, Jeton Mehmeti, kanë përfunduar E-kioskun përmes së cilës

qytetarët e komunës do të pajisen me çertifikata të gjendjes civile. E-kiosku i vendosur para objektit të komunës do të jetë në shërbim të qytetarëve 24 orë, në shtatë ditë të javës. Kryetari Jashari ka thënë se me këtë projekt po jetësohet edhe një premtim i dhënë, për të ofruar shërbime cilësore dhe të shpejta për qytetarët e Skenderajt.



Komuna e Inegylit dhuron maska për Komunën e Mitrovicës

MITROVICË, 19 GUSHT (ER) - Nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, së bashku me drejtorin për Kulturë, Rini dhe Sport, Tafil Peci, kanë pranuar një donacion me 10 000 maska për qytetarët e Mitrovicës nga kryetari i Komunës së Inegylit, Alper Taban, me të cilin qytet Mitrovica është binjakëzuar. Me këtë rast, nënkryetari Mujka ka falënderuar kryetarin Taban për dhurimin e këtij donacioni shumë të nevojshëm në këtë kohë pandemie, duke thënë se këto

maska mbrojtëse do të shërbejnë për nevojat e qytetarëve. Sipas tij, ndihma të tilla janë të mirëseardhura për ta tejkuluar situatën e krijuar nga pandemia globale e virusit Covid-19. Po ashtu, Mujka është shprehur mirënjohës ndaj Tabanit dhe gjithë qytetarëve të Inegylit të cilët edhe një herë kanë treguar solidaritetin dhe respektin që kanë për qytetarët e Mitrovicës si dhe për bashkëpunimin e mirë që kanë deri më tani.

KURRË NUK DO TË ARRIHET TË NJOLLOSET KOMBI YNË, KOSOVA KA HISTORI TË LAVDISHME (31)



Shkruan: Kudusi LAMA

Aktorët ndërkombëtarë që morën drejtimin në Kosovë u lidhën dhe u mbështetën te të gjitha strukturat dhe individët që kishin bashkëpunuar me Serbinë gjithë jetën. Do të thoni ju që ata nuk ishin në udhëheqje. Atë e kam të qartë se edhe po ta kishin mendimin tuaj, ose të ishit ju vetë nuk e bënit dot, se për lirinë u bë një luftë e madhe. Por të gjithë informatorët dhe bashkëpunëtorët e niveleve vepruese ishin ish-bashkëpunëtorë të Serbisë. Dhe ta dini zotëri, megjithëse edhe sot Serbia deklaroi që ka shërbim të fuqishëm informativ në Kosovë, kurrë nuk do të arrihet të njolloset kombi ynë, sepse gjithë historinë e ka të lavdishme.

Në pjesën e dytë të pikës 10 ju shpreheni: “Në fakt, menjëherë pas përfundimit të konfliktit, kur UÇK-ja kishte praktikisht e vetme kontrollin në terren, u kryen shumë larje hesapesh midis tarafesh të ndryshme dhe ndaj atyre që konsideroheshin, pa asnjë formë procesi gjyqësor, si tradhtarë, sepse dyshoheshin se kishin bashkëpunuar më parë me autoritetet serbe në vend”. Më duket se gjithë informacionin e keni marrë prej kundërshtimit dhe e keni ndërtuar me keqdashje, sepse po të kishit marrë informacion të saktë do të ishit informuar se në Kosovë gjatë dhe pas Luftës Çlirimtare nuk ka pasur asnjë element të luftës civile, që realisht duket se e keni pasur shumë me dëshirë ju zotëri Marty dhe serbët që ua kanë servuar raportin tuaj. Në Kosovë dhe në gjithë hapësirën shqiptare jemi krenar se kurrë nuk ka pasur luftë civile me gjithë përpjekjet që janë bërë shpesh në histori për të na futur në lojëra të tilla të rënda. Dhe duhet të dini se ne i njohim luftërat civile të kombeve të tjera gjatë historisë.

Ndërsa sa u përket atyre që kanë bashkëpunuar me Serbinë kundër UÇK-së duhet të jeni të qartë se ka pasur mjaft kohë për t'i likuiduar që në fillim të luftës, siç ndodh gjithnjë gjatë luftërave çlirimtare, në qoftë se do t'i kishin zënë rrugën ose do të ishin vendosur në vijat e fronteve bashkë me serbët përballë luftëtarëve. Kurse kur lufta kishte përfunduar askush nuk është marrë me ta. Sepse tani në liri shqiptarët të lodhur nga lufta nuk kishin më dëshirë të merreshin me këtë kategori. Dhe përgjithësisht Serbia bashkëpunëtorët i ka marrë me vete, ju e dini mirë këtë. Se nuk do të ndodhte ndryshe se ç'ka ndodhur me pushtuesit e vendeve

të tjera, apo edhe me pushtuesit që kanë pushtuar territoret shqiptare gjatë historisë.

Në pikën 11, duke u përpjekur të justifikoni veten, ju hidhni gurë kundër UNMIK-ut, se nuk paska punuar mirë dhe se me ardhjen e EULEX-it dhe ardhjen tuaj gjendja ka ndryshuar, por çfarë t'i bësh se u paska mbetur pa zbuluar ajo që doni ju “për krimet e luftës të kryera kundër serbëve e kosovarëve shqiptarë të konsideruar si bashkëpunëtorë apo si pjesëmarrës të fraksioneve kundërshtarë. Kjo çështje e fundit përbën një tabu të vërtetë sot e kësaj dite në Kosovë, edhe pse gojë më gojë e me shumë kujdes, të gjithë flasin për një gjë të tillë”. Zotëri, a e dini se luftëtarët e UÇK-së nuk kanë në historinë e luftës së tyre asnjë civil serb, asnjë fëmijë, grua apo plak serb të vrarë gjatë luftës, asnjë shtëpi të djegur dhe asnjë grabitje në shtëpitë e serbëve? Po çfarë paskeni pritur ju, që edhe burrat luftëtar të mos i kishin vrarë në frontet e luftës? Nuk e dini ju se lufta bëhet për të vrarë burra që rreshtohen në formacionet e armikut? A keni marrë vesh ju se UÇK-ja ka lënë në frontet e luftës me ushtrinë dhe policinë serbe rreth 2 mijë dëshmorë? Vërtetë jeni interesant, dhe nuk u vjen çudi me veten për mënyrën se si arsyetoni.

Ndërsa duhet të dini profesionalisht, se fati i kësaj Luftë Çlirimtare ka qenë se nuk pati fraksione, siç do të kishit pasur dëshirë ju. Në atë luftë pati një ushtri që quhej Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe që e kreu detyrën. Këtë e di edhe NATO-ja që luftoi bashkë me të e që më lartë e keni pranuar edhe ju megjithëse në sensin për keqdashje. Kështu që, në qoftë se ka ndodhur ndonjë vrasje, që mund ta evidentoni ju, gjeni arsytet, por mos e lidhni abuzivisht me luftën duke përdorur terminologji sikur ne këtu jemi një tufë të paditurish dhe habitemi me fuqinë tuaj në të shprehur e në shtrim të problemeve.

Më poshtë në pikën 12, shpreheni “Ekipi i prokurorëve dhe hetuesve ndërkombëtarë në gjirin e misionit të EULEX-it, ngarkuar për të vërtetuar pretendimet lidhur me trajtimet çnjerëzore, përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me një trafikim të mundshëm organesh, ka bërë përparime konkretisht për sa i përket provës së ekzistencës së vendeve të fshehta të burgimit të UÇK-së në veri të Shqipërisë ku thuhet se janë kryer trajtime çnjerëzore, madje edhe vrasje. Hetimi, megjithatë, nuk ka gjetur mbështetjen e duhur për bashkëpunim nga ana e autoriteteve shqiptare”. Çudi, që ju paskan penguar autoritetet shqiptare, sepse me sa di unë këto autoritete gjithnjë iu kanë ofruar publikisht gjithë ndihmën e nevojshme që të sqaroheni për çdo pretendim. Asnjëherë nuk kam dëgjuar t'u jenë kundërvënë. Ndërsa unë mendoj se u kanë

dhënë aq shumë hapësirë, sa vërtetë nuk duhet ta kishin bërë, përdërisa ju jeni aq pak serioz, sa kur nuk gjeni çfarë dëshironi, propagandoni pengesën e autoriteteve shqiptare, për të mos deklaruar dështimin tuaj, pasi jeni duke ecur mbi mashtrimin. Pse në raportin tuaj nuk emërtoni kush iu ka penguar? Apo nuk ka rëndësi, pasi ju konsideroheni i fituar në fushën propagandistike kundërshtimit dhe kaq iu mjafton. Shqipëria ka pasur autoritete edhe kur zhvillohej lufta, nuk ka qenë tokë e shkrete, që ju ta zbuloni sot zotëri.

Ndërsa në pikën 13, jeni më i drejtpërdrejtë për synimin se ku doni të arrini duke u deklaruar: “Emocioni që ngjallën në rrafsh botëror krimet e llahtarshme të bëra nga forcat serbe krijoi një atmosferë të tillë, që mund të vihej re edhe në qëndrimin e disa instancave ndërkombëtare, duke u mbështetur në mendësinë se disa konsideroheshin doemos si xhelatë, dhe të tjerët si viktimë, pra pashmangshmërisht të pafajshëm. Realiteti është më i nuancuar e kompleks”. Pra, keqardhja juaj është se instancat ndërkombëtare qenkan emocionuar nga krimet serbe, duke bërë të mos shihen krimet e viktimitës. Unë e kam kuptuar se synimi juaj nuk është tjetër veçse të kriminalizojë pikërisht këtë - viktimitën për ta barazuar me kriminelin. Po pse more zotëri ke kaq urrejtje për gjithë ata shqiptarë të vrarë? A e di zotëri se sipas statistikave për një shekull, Serbia ka zhdukur 77 % (për qind) të shqiptarëve në trojet e pushtuara dhe se këto shqiptarë që jetojnë sot janë pasardhës të vetëm 23% (për qind) të tyre? Ulu njëherë dhe vëre gishtin në kokë thonë shqiptarët. Nuk janë emocionuar instancat ndërkombëtare, zotëri, por këto instanca të emocionuara sipas jush, na kanë borxhe të mëdha, pasi kanë pjesën e tyre të fajit për vdekjen e gjithë atyre shqiptarëve ndër kohëra e kanë peshë në ndërgjegjen e tyre.

Realisht serbët dhe Serbia në Kosovë dhe në gjithë trojet e pushtuara shqiptare historikisht kanë kryer rolin dhe funksionin e xhelatit mbi shqiptarët, duke ua marrë jetën si kanë dashur. Lexoni zotëri dialogun e Millosheviqit me Gjeneralin Klark, në takimin e tyre të vitit 1999, në Beograd, në librin e tij “Të bësh luftë moderne”, që të sqarohesh se çfarë kanë bërë dhe kërkonin të bënin serbët mbi shqiptarët.

Prandaj edhe sado dëshirë të keni, nuk keni për t'ia arritur kurrë qëllimit të barasvlerësoni shqiptarët me serbët në rrugën e krimet kundër njerëzimit, sepse serbët janë të njohur botërisht për krimet e tyre. Mos bëni shaka zotëri me terma tragjike.

Pika 15, është vërtetë interesante, pasi aty ju thoni: “Nuk mund dhe nuk duhet të ekzistojë një drejtësi për fituesit dhe një tjetër drejtësi për të mundurit. Në çdo konflikt,

tërë kriminelët duhet të ndiqen penalisht dhe të cilësohen përgjegjës për aktet e tyre të paligjshme, cilido qoftë kampi të cilit i përkasin dhe pavarësisht nga roli politik që kryejnë”. Jam plotësisht dakord me ju, për këtë pikë, më gëzon fakti që në këtë rast keni marrë rolin e të mundurit (Serbisë), duke kërkuar që edhe shqiptarët (fitimtarët) të vlerësohen për veprat e tyre njëjloj si serbët.

Po kur do të trajtohen serbët si kriminelë, kur do të japin llogari për gjithë vrasjet që kanë bërë, për të gjitha masakrat, për të gjitha shkatërrimet, për të gjitha shpërnguljet, për gjithë gjenocidin, për gjithë prapësitë që kanë shkaktuar, për të gjitha përdhunimet, për të gjitha djegiet e shtëpive, për gjithë ata operacione zhdukje ndaj shqiptarëve, për të gjithë të zhdukurit, për gjithë fëmijët pa prindër e prindërit pa fëmijë, për të gjithë pensionistët pa pensione, për të gjithë pasurinë e marrë, për gjithë pastrimet etnike e grabitjen me tjetërsim të tokave shqiptare, për të gjitha shpifjet, për të gjitha konfliktet ndërshtetërore që kanë përgatitur, për të gjitha opinionet që kanë përgatitur për opinionin ndërkombëtar për portretin e shqiptarëve etj. Pra, unë jam dakord me ju që të trajtohen njëjloj të gjithë ata që kanë bërë krime, po kur do ta përgatisësh raportin për Serbinë, për ushtrinë e policinë serbe, për kriminelët serb, që të jesh i sigurt janë me mijëra? Bëje edhe këtë, që të pastrosh sadopak, këtë portret që krijove për veten në opinionin mbarëbotëror, duke u munduar të njollosësh portretin e luftëtarëve shqiptar për liri dhe të Ushtrisë së tyre Çlirimtare.

Por unë nuk bindem dot se ju mund të jeni i drejtë në vlerësimin e kriminelit dhe të viktimitës, kur lexoj në pikën 16 të kësaj rezolute: “Ndërsa Serbia më në fund arriti të bashkëpunojë, realizimi i gërmimeve në territorin e Kosovës u shfaq shumë më i komplikuar, kurse në territorin shqiptar ka qenë i pamundur, të paktën gjer më sot. Bashkëpunimi me autoritetet kosovare lë për të dëshiruar sidomos për sa u përket kërkimeve për rreth 500 persona zyrtarisht të zhdukur pas përfundimit të konfliktit”.

Së pari, dua t'iu sqaroj se në Kosovë nuk ka pasur një konflikt që mund të ishte zgjidhur edhe me bisedime, por një luftë të armatosur të një populli për liri, kundër të cilit Serbia pushtuese ka përdorur gjithë arsenalin e saj të armëve prej pistoletave e pushkëve, mitralozëve e topave, tankeve e autobindave, helikopterëve e avionëve gjuajtës - bombardues e deri tek raketat që ka disponuar, pa dalluar se ku lejohet e ku nuk lejohet për të goditur sipas konventave ndërkombëtare. Për këtë mund të shihet edhe plani i përdorimit luftarak të artillerisë në Kosovë, të cilin unë e disponoj në original,

që e kanë përgatitur bashkëpunëtorët e tu serb. Të cilin e kam paraqitur në këtë punim më lartë të fotografuar.

Së dyti, ju duket se shpreheni që flitet për vrasje të kryera pas lufte, e realisht nuk kuptohet se si mund të jenë bërë këto vrasje kur nuk kishte luftë.

Së treti, ju përdorni shifrën 500, por nuk vini asnjë emër, adresë e portret të asnjë prej këtyre që juve iu kanë humbur. Ndërsa shqiptarët kanë emrat e mbiemrat, portretet dhe gjeneralitetet, familjet dhe të afërmit, vendbanimet dhe shtëpitë, prindërit dhe fëmijët e mbi 14 mijë të vrarëve e të zhdukurve, dhe ju nuk iu bëjnë fare përshtypje.

Së katërti, ju ankoheni se në Kosovë e Shqipëri iu kanë penguar të gërmoni. Po si u kanë penguar nuk e thoni, pasi nuk dini çfarë të thoni, për vetë faktin se edhe sikur ta gërmoni gjithë tokën shqiptare, nuk do të gjeni varreza masive, siç pretendoni ju, pasi nuk është në zakonin tonë të fshehim varrezat, në traditën tonë njeriu është edhe armik deri në momentin që vdes, prej këtij momenti ai duhet nderuar dhe në këtë e kemi bërë historikisht dhe e bëjmë. Ne e dimë që për këto çështje Serbia gjithnjë na ngatërron me veten, po ju pse na ngatërroni, a mos edhe ju keni të njëjtën traditë si serbët që të luftoni edhe kundër kufomave?

Së pesti, ju e quani bashkëpunëtorë të mirë Serbinë, se ajo paska bashkëpunuar me ju, por për çfarë ka bashkëpunuar? Ne akoma kemi një masë të madhe njerëzish të humbur. A dini ku u ka thënë Serbia se e ka Ukshin Hotin, një personalitet shqiptar me vlera universale, që nuk po kthehet në shtëpi? Ne e duam bashkëpunimin me emra zotëri. A ke dëshirë të rreshtoj të gjithë emrat e të zhdukurve që vazhdojmë t'i presim të na i kthejë Serbia?

Pas këtyre komenteve të rezolutës shoqëruese, le të lexojmë e vlerësojmë raportin e zotëri Dick Martyt, duke nxjerrë konkluzione e duke bërë në fund komentet e nevojshme sqaruese.

Pasi e kemi lexuar me kujdes këtë raport, lind vetvetiu nevoja për ta marrë në analizë pikë për pikë që të kuptojmë më mirë se cili është edhe qëllimi i këtij zotëri Marty-t, që bën këtë raport tepër denigruar dhe keqdashës për kombin shqiptar, për Kosovën e shqiptarët që e banojnë, për Luftën Çlirimtare të Kosovës, për UÇK-në si bartëse krenare e me dinjitet të kësaj lufte, për luftëtarët, invalidët, dëshmorët dhe viktimat e shumta të kësaj lufte, që ishte rrjedhojë e pushtimit nga Serbia dhe domosdoshmërisë së hedhjes së saj jashtë Kosovës me forcën e armëve dhe me gjakun e shumë shqiptarëve. (Vijon)

Qyteti antik i Antigonesë në Gjirokastrë që u ndërtuar nga mbreti Pirro

Antigonea u ndërtua në vitin 295 para Krishtit me urdhër të mbretit Pirro. Qyteti u emërua sipas gruas së tij të parë Antigone

Antigonea është një nga qytetet më të mëdha antike në Shqipëri dhe vendbanimi më i rëndësishëm antik në Luginën e Drinos. Vendbanimi ka një sipërfaqe prej 45 hektarësh dhe i gjithë parku arkeologjik ka një sipërfaqe prej 95 hektarësh. Qyteti ishte fortifikuar me mure të trasha në fillim të shekullit të tretë para Krishtit, si vazhdimësi e ekzistencës të një vendbanimi të hershëm, emri i të cilit u ndryshua nga Pirroja.

Qyteti mbizotëronte zonat e pasura rurale të Luginës së

portat e qytetit. Rrugët Veri-Jug janë më të gjera dhe më të rëndësishme dhe të pajisura me trotuar të gjerë. Disa rrugë tregojnë edhe kanale për kullimin e ujit. Rruga më e rëndësishme në qendër të gërmimeve është emëruar Dhimosten Budina. Rrugët kufizoheshin me shtëpi banimi. Disa apartamente u zbuluan plotësisht gjatë gërmimeve arkeologjike.

Më të mrekullueshëm janë ata me oborrin e brendshëm me kolona të rrethuara nga zona



pamjen më të bukur të luginës së lumit Drinos. Që nga mesnata agora kufizohet me një tryezë, e cila ishte struktura më e

metra. Vendi shërbeu si një treg ku banorët sollën produktet e tyre. Edhe pse Antigonea u dogj në shekullin e tretë, të dhënat

argumentuan për vendndodhjen e qytetit për dekada. Merita kryesore për zbulimin e saj i takon arkeologut shqiptar Dhimosten Budina, i cili arriti të gjente karta votimi argjendi me stemën e qytetit Antigonesë dhe një çelës për portat e qytetit me vetë emrin e qytetit gjatë gërmimeve midis viteve të 70.

Gërmimet arkeologjike të organizuara nga ai zbuluan të paktën 10 ndërtesa private, rrugë të veshura me pllaka, tuba të ujërave të zeza dhe trotuar. Sipas arkeologëve dhe ekspertëve të antikitetit, në luginën e Drinos pranë Gjirokastrës, ekziston një numër jashtëzakonisht i madh i mbetjeve arkeologjike dhe antike. Përafërsisht 20 prej këtyre vendeve janë identifikuar deri më tani, duke përfshirë qytetet antike dhe fortifikimet, varret dhe teatrot. / KultPlus.com




rëndësishme publike brenda mureve të qytetit. Tryeza është e gjatë rreth 70

arkeologjike tregojnë se ajo ende ekzistonte në antikitetin e vonë (shek. IV-VI). Arkeologët

Drinosë dhe kishte fortifikime të tjera periferike për të mbrojtur të gjithë territorin: Kështjellën e Lekliut në veri, Labova në lindje dhe Selo në jug. Qarku i mbrojtjes mund të përshkohet i tëri, që nga hyrja në këtë park. Në pjesën veriore të qytetit, në hyrjen e anës së djathtë, ka një kodër të quajtur "Acropolis". Në pikën më të lartë të kodrës ka rrënoja të kishës pas mesjetës së Shën Mikalit. Gërmimet intensive arkeologjike brenda zonës së qytetit në vitet e 70-ta kanë zbuluar pjesët më të banuara si dhe rrjetet rrugore. Rrugët që kalonin në veri-jug dhe lindje-perëndim ishin pingul. Rrugët më të rëndësishme mbarojnë në

banimi dhe ato tregtare. Muret e banimit ishin bërë me blloqe guri që kishin gdhendje vetëm në fundin e tyre kurse në pjesën e sipërme ishte e ndërtuar me tulla të papërpunuara. Gërmimet arkeologjike në Antigonea zbuluan shumë objekte interesante, përfshirë bronzin. Ndoshta gjëja më interesante është figura e sfinksit kafe, e cila sot është simboli i qytetit. Gjetje të tjera të rëndësishme janë çelësat prej bronzi me emrin qytet të ngulitur. Zbulimi i këtyre çelësave konfirmoi vendndodhjen e Antigonesë. Në pjesën perëndimore të qytetit gjendet agora, qendra e qytetit. Këtu mund të admirojmë edhe







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



E rrallë

Një qytet zviceran u mbulua nga copëzat e çokollatës

Banorët e Oltenit, një qytet që gjendet ndërmjet Zvicrës dhe Bazelit, u tronditën kur panë grimca të imëta kakaoje nëpër objekte. Kjo, sipas autoriteteve të vendit, ndodhi pasi që sistemi i ventilimit të një fabrike çokollate doli jashtë funksionit. Firma "Lindt & Spruengli" ka konfirmuar për mediat lokale atje, se ekzistonte një defekt i vogël në ventilimin e ftohjes.



BARSOLETA E DITËS



Mungesat

Babai: Cila është arsyeja që ke kaq shumë mungesa në lëndën Gjuhë shqipe?

Djali: Nuk e di, nuk kam qenë aty.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje

FOTO E DITES



Pamje e shkrepur nga lart në plazhin e 'Gjeneralit' në Shqipëri



E jashtëzakonshme

Llava e vullkanit e "përpin" një veturë

Disa pamje të siguruar nga dëshmitarë të vendit të ngjarjes, më pas të ngarkuara nga platforma e videoeve 'Viral Hog', tregojnë çastin kur vullkani

e shkrin një veturë të tipit 'Mustang'. Pamjet janë mundësuar në xhirim të ngadalësuar, të cilat tregojnë me përpikëri shpejtësinë e shkrirjes së veturës.

Pllaka përkujtimore për Nënë Terezën në Shkup, tani e qasshme dhe në tri gjuhë



Qyteti i Shkupit e ka rregulluar Pllakën përkujtimore të Nënë Terezës në qendër të Shkupit, gjegjësisht në Sheshin Maqedonia, pasi që me vendosjen e parkut, u pamundësua qasja e njerëzve që për së afërmi ta vizitojnë apo të vendosin lule, për çka Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve (ITSHKSH), disa herë doli me kërkesë që të zgjidhet çështja. Për dallim prej të vjetrës, pllaka e re përkujtimore është në tri gjuhë, maqedonase, shqipe

dhe angleze. "Pllaka përkujtimore e Nënë Terezës në Shkup, me zgjidhje të re dinjitoze. Qasje deri te pllaka e re në Sheshin Maqedonia", shkroi në Facebook kryetari i Qytetit të Shkupit, Petre Shilegov. Ai publikoi edhe disa fotografi nga fundamenti i ri i vendosur, ndërkaq komentuesit janë të ndarë në lidhje me këtë çështje. Derisa disa e urojnë për punën e kryer, disa të tjerë e kritikojnë duke i thënë "mjaft më me përmendore për Nënë



Terezën". ITSHKSH vlerësonte se me ndryshimet e bëra në Sheshin Maqedonia, janë mbuluar gjurmët e shtëpisë së Nënë Terezë, ndërsa me parkun e vendosur para pllakës përkujtimore praktikisht është mbyllur rruga që të vendosen lule edhe te pllaka. Departamenti i ITSHKSH-së për Mbrojtjen e Trashëgimisë së Gonxhe Bojaxhiut – Nënë Terezë, ka shprehur indinjatë dhe habi të thellë për këtë veprim të papërgjegjshëm të Qytetit të

Shkupit. "Në kohën që e gjithë bota mburret me emrin dhe veprën e Nënë Terezë dhe ajo është bërë identiteti dhe letërnjoftimi i vendit tonë, të mbulohen gjurmët e shtëpisë së saj dhe të pengohet mundësia e vendosjes së luleve në pllakën përkujtimore nuk ka si lexohet ndryshe, pos si një veprim i papërgjegjshëm dhe i dëmshëm për qytetin tonë, por edhe për gjithë vendin tonë", deklaruan nga ITSHKSH. / Portalb.mk.

 <p>DASHI Nuk do ta dini me siguri se si ta bëni një punë pa ia nisur më parë. Fatmirësisht, ju jeni ndër ata persona që i pëlqen sfidat. Përveshni mëngët dhe futuni punës.</p>	 <p>DEMI Mund t'ju duket herë pas herë se bota është kundër jush, por kjo nuk është e vërtetë.</p>	 <p>BINJAKËT Ju nuk keni bërë një gabim që ka rëndësi të madhe siç pretendoni. Çdokush gabon nganjëherë.</p>	 <p>GAFORRJA Ndoshta duhet t'i bëni rregullimet e nevojshme edhe në jetën tuaj personale, një rregullim që t'ju vendosë ju në qendër të gjërave.</p>	 <p>LUANI Nëse ndieni se jeni në vështirësi, atëherë duhet të kërkonin ndihmë. Problemi i vërtetë është se si të gjithë të tjerët, as ju nuk mund ta zgjidhni gjithçka vetë.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Ditët në vijim do të zgjohet interesi juaj për një projekt nga i cili keni hequr dorë kohë më parë.</p>
 <p>PESHORJA Ditët në vijim mund të keni probleme me vetëbesimin tuaj si pasojë e aktivitetit kozmik, por mos u përpuni t'i shmangni pyetjet e vështira.</p>	 <p>AKREPI Ndihet qartë se liria juaj për të lëvizur sipas dëshirës ka marrë një goditje kohët e fundit, por ditët në vijim do të zgjidhen "zinxhirët" që ju pengojnë.</p>	 <p>SHIGJETARI Përpuni të mos lejoni njeri t'ju vendosë poshtë me fillimin e javës. Kujtojeni vetes se suksesi varet vetëm nga ju.</p>	 <p>BRICJAPI Çfarëdo të ndodhë në vijim, e mirë apo e keqe, duhet të besoni që në afatin e gjatë gjithçka do të funksionojë.</p>	 <p>UJORI Shpirti juaj revolucionar nuk është dukur shumë kohët e fundit. Është koha ta rizbuloni veten dhe pasionet tuaja.</p>	 <p>PESHQIT Thonë që ajo që nuk ju shkatërron ju bën më të fortë dhe në javët që vijnë do të kuptoni se kjo është e vërtetë.</p>

Kanye West ndan në “Twitter” foton e mrekullueshme me vajzën e tij



Kanye West ka ndarë me ndjekësit në “Twitter” një fotografi të adhureshme së bashku me vajzën North. Reperi 43-vjeçar nuk ka qenë shumë korrekt me deklaratat në rrjetet sociale, mbi të gjitha, në lidhje me partneren Kim Kardashian, së cilës më vonë i

kërkoi falje publikisht. Ai ka përdorur platformën për një qëllim më pozitiv, pasi ndau një fotografi të bukur me vajzën e tij shtatëvjeçare, North, teksa qëndronin buzë ujit dhe pas tyre dukeshin disa male. Kanye ka shkruar krah fotos “duke kaluar kohë babë e bijë”.



Madonna ndan pamje nga ditëlindja e 62-të, shihet pranë të dashurit 26-vjeçar

Këngëtarja Madonna së fundmi e ka festuar ditëlindjen e 62-të. Ajo zgjodhi Xhamajkën për t’u argëtuar me miqtë dhe të dashurin 26-vjeçar. Pas fotos ku shihet me një pjatë marijuanë,

Madonna tashmë e ka ndarë një video ku shkëput çastet e këndshme nga ajo mbrëmje. “Festa e Ditëlindjes vazhdon në Xhamajka”, ka shkruar ajo. Urimet ishin të shumta dhe dhuratat nuk kanë munguar.

Georgina ndan çaste intime me Ronaldon nga jahti luksoz në Saint Tropez



Cristiano Ronaldo dhe partnerja e tij Georgina në fillim të pandemisë siguroheshin që të rrinë në shtëpi dhe të ruhet ndaj Covid-19. Mirëpo ka javë që ata udhëtojnë nga njëri vend në tjetrin për t’i kaluar pushimet në bregdet. Të


dy me ndjekësit kanë ndarë imazhe të ndryshme, ndërsa ishte Georgina ajo e cila së fundmi i ka publikuar disa çaste intime me Ronaldon në jaht. Dyshja dukeshin mjaft të lumtur krah njëri-tjetrit dhe shihet se pushimet po kalojnë mjaft mirë.

Can Yaman përfundon në gjykatë



Aktori Can Yaman ka përfunduar në gjykatë dhe lajmi po bën bujë në mediat e huaja. Can Yaman, i cili u bë shumë i njohur me rolin e “Xhanit” në serialin “Një puthje në errësirë”, po akuzohet nga një kolege e vet aktore, Selen Soyder. Me këtë të fundit Can Yaman ka luajtur në serialin “Hangimiz Sevmedik”. Selen e akuzon Yaman se ka hedhur çaj të nxe-

htë tek ajo teksa po debatnin. Can Yaman deklaroi se e ka hedhur gotën me çaj në dysheme, por Selen e mohon këtë. Yaman duhet t’i paguajë aktore 1 200 euro. Pavarësisht prej kësaj ngjarjeje, Can Yaman po vazhdon me sukses karrierën. Ai luan aktualisht në një nga serialet më të ndjekur në Turqi me titull “Bay Yanlis”, krah aktore Ozge Gurel.



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Shatri: Dëshira është e madhe për të pasur sukses në arenën ndërkombëtare

PRISHTINË, 19 GUSHT - Kosova A (femrat) pritet të marrë pjesë në FIBA Kampionatin Evropian të Shteteve të Vogla që do të organizohet në vitin e ardhshëm në Nicosia të Qipros prej 15 deri më 20 qershor. Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës detyrën e përzgjedhës ia ka besuar Fidan Shatrit, i cili më herët ka qenë përzgjedhës i Kosovës U16, U18, U20 te femrat, derisa tani edhe i Kosovës A (femrat). Shatri ka fituar pesë trofe me KBF Prishtinën dhe për vite të tëra ka punuar në basketbollin e femrave në Kosovë. Në një intervistë për faqen zyrtare të FBK-së, ai flet për formimin e Kosovës A te femrat, pjesëmarrjen në garat ndërkombëtare dhe synimet.

Sa është i rëndësishëm formimi i Kosovës A (Femrat)?

Shatri: Formimi i Përfaqësues A të femrave është shumë i rëndësishëm sepse vashat tona fitojnë përvojë në garat ndërkombëtare dhe kemi mundësi të shohim se në çfarë niveli jemi në krahasim me vendet e tjera. Gjithashtu, është një motivim për lojtarët e reja, që

të 'luftojnë' për 12-shen më të mirë të Kosovës, sepse deri më tani një gjë e tillë nuk ka ndodhur.

Sa ka rëndësi pjesëmarrja në garat ndërkombëtare?

Shatri: Në garat ndërkombëtare basketbollistët e Kosovës do të fitojnë përvojë, që do t'u ndihmoj shumë atyre në të ardhmen. Është shumë e rëndësishme ta përfaqësosh shtetin tënd në garat ndërkombëtare. Besoj se do ta japim maksimumin tonë në çdo paraqitje në arenën ndërkombëtare.

Sa e ndihmon kjo basketbollin e femrave në Kosovë?

Shatri: Për të gjitha lojtarët është një motivim shumë i madh në mënyrë që të luajnë për Kosovën A. Shumë gjenerata kanë ëndërruar për këtë ditë që të luajnë në arenën ndërkombëtare, ndërsa ne do ta kemi fatin që ta prezantojmë vendin në vitin e ardhshëm. Mendoj se edhe për vashat e Kosovës është një motivim i madh që të luajnë për Kosovën A. Ato e dinë rëndësinë dhe besoj se do ta japin maksimumin.



Ku do të jetë fokusi juaj?

Shatri: Ne do të përpiqemi të kemi paraqitje sa më të mira. Sigurisht se nuk do të jetë lehtë për shkak se është hera e parë. Do të përpiqemi të krijojmë një ekip, me lojtare me përvojë, por edhe

me ato më të reja në moshë që premtojnë shumë në të ardhmen. Kemi disa basketbolliste që luajnë jashtë Kosovës, që mund të grumbullohen, por edhe nga Superliga e Femrave.

Cilat janë synimet?

Shatri: Qëllimi ynë është të krijojmë një skuadër për të ardhmen. Na mungon përvoja në gara të tilla, por sigurisht se nuk do të luajmë me flamur të bardhë. Synimet janë të fitojmë përvojë, por edhe për paraqitje dinjitoze në garat ndërkombëtare. Besoj se angazhimi do të jetë maksimal nga të gjithë, sepse dëshira është e madhe për të pasur sukses në arenën ndërkombëtare. Në FIBA Kampionatin Evropian për Shtetet e Vogla-Femrat në vitin 2020 janë paraqitur për të garuar: Andorra, Qipro, Gjibraltari, Irlanda, Luksemburgu, Malta dhe Norvegjia, por që u anulua për shkak të pandemisë Covid-19. Regjistrimi i shteteve për pjesëmarrje në FIBA Kampionate Evropiane në FIBA Europe do të bëhet si zakonisht, pra ndërmjet muajve shtator/tetor 2020. FIBA Evropa ka kërkuar nga të gjitha Federatat Nacionale që t'i regjistrojnë ekipet e tyre për vitin 2021, pasi regjistrimet e paraqitura për vitin 2020 nuk do të merren parasysh.

Mbahet trajnimi online për platformat 'FIFA Connect' dhe 'FIFA TMS'



PRISHTINË, 19 GUSHT - Federata e Futbollit e Kosovës është duke mbajtur trajnimin online me administratorët e klubeve të Superligës dhe Ligës së Parë rreth platformave të regjistrimit të lojtarëve "FIFA Connect" dhe "FIFA TMS". Në hapje të këtij trajnimi pjesëmarrësit i përshëndeti kryetari i FFK-së, Agim Ademi, i cili ua shpjegoi administratorëve të klubeve rëndësinë e këtyre platformave elektronike si dhe rihesoi përkrahjen e vazhdueshme që FFK-ja do ta japë për klubet. "FFK-ja është duke i bërë të gjitha përgatitjet për edicionin e ri të garave që është paraparë

të nisë më 12 shtator dhe me këtë rast kërkoi edhe nga klubet që të punojnë intensivisht për një nismë sa më të mbarë në këto kushte dhe rrethana të vështira si pasojë e pandemisë Covid-19", thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit të Kosovës.

Ky trajnim për klube po realizohet nga zyrtarët e FFK-së: Dardan Sadiku, Arta Osmani dhe Zgjim Sojeva. Gjatë këtij trajnimi po diskutohet rreth regjistrimit të lojtarëve vendorë, transferimet vendorë dhe ndërkombëtare si dhe për programet e solidaritetit të FIFA-s.

Gjilan sonte përballlet me Tre Penne

PRISHTINË, 19 GUSHT - Skuadra e Gjilanit ka mbërritur të mërkurën në mesditë në San Marino, atje ku pritet ta zhvillojë ndeshjen e raundit

parakualifikues në Ligën e Evropës, kundër Tre Penne. Gjilani me Tre Penne do të përballlet të enjten nga ora 21:00 në stadiumin "Stadio

Olimpico di Serravalle" në San Marino. Skuadra iu është nënshtruar matjes së temperaturës për të gjithë anëtarët. Keita Aziz mungon për shkak

të dokumenteve, ndërsa Sebino Plaku mungon për arsye lëndimi në muskulin e këmbës të pësuar në stërvitje.



Mazrekaj nënshkruan për Laçin

PRISHTINË, 19 GUSHT - Mentor Mazrekaj rikthehet në Superiore dhe do ta veshë fanellën e Laçit. Sulmuesi anësor sezonin e fundit ishte pjesë e Llapit në IPKO

Superliga e Kosovës dhe mundohet të tregojë që ende ka vlera dhe mund të japë në futbollin shqiptar. "Kam firmosur kontratë me skuadrën e Laçit. Falënderoj

familjen bardh e zi si dhe presidentin Pashk Laska për këtë mundësi për t'i ritreguar edhe një herë vlerat e mia", ka shkruar Mazrekaj në profilin e vet në "Facebook". Edhe

klubi i Laçit e ka njoftuar afrimin e sulmuesit dardan, i cili ka spikatur në të shkuarën me Partizanin dhe më pas një dëmtim e penalizoi të rikthehej i mëparshmi.



Iir Veliqi zgjidhet kryetar i KF Drenica

SKENDERAJ, 19 GUSHT - KF Drenica ka zgjedhur organet e reja drejtuese të klubit. Në rolin e kryetarit të klubit është zgjedhur biznesmeni Iir Veliqi, i cili ishte kryetar i klubit edhe në vitin 2018. Anëtarë të tjerë të bordit janë zgjedhur Rexhep Birinxhiku, Ismet Mustafa, Ilaz Halili, Hajrullah Lushtaku, Haradin Deliu, Bashkim Rushiti, Lulzim Fazliu, Albert Lushtaku, Nazmi Xani dhe Avdi Tahiraj. Nënkryetar i klubit është zgjedhur Rexhep Birinxhiku, kurse drejtor sportiv i klubit është zgjedhur Lulzim Fazliu. "Rol vendimtar në këtë mbledhje, si gjithmonë, pati kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, si dhe drejtori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit i Skenderajt, Abdyl Ymeri, të



cilët u dhanë mbështetje të plotë organeve të reja drejtuese, duke u uruar suksese. Ndërsa bordi i ri tashmë do të angazhohet për

konsolidimin e skuadrës dhe kryesisë për t'u përgatitur për edicionin e ri të garave 2020/2021", thuhet në njoftimin e KF Drenica.

Lakersat zhgënjejnë ndaj Portlandit



ORLANDO, 19 GUSHT - Orlando Magicu e nisi mjaft mirë fazën "play-off", pasi ia doli të triumfojë me shifrat 122-110 përballë Milwaukee Bucksit, në sfidën e zhvilluar në "HP Field House". I udhëhequr nga malazezi Nikola Vučević, i cili shënoi 35 pikë, rikuperoi 14 topa dhe dha 4 asistime, Magicu vendosi një avantazh të konsiderueshëm që në fraksionin e parë të lojës dhe më pas e menaxhoi mirë atë, për ta regjistruar suksesin e parë. Nga ana tjetër, Milwaukee Bucksit bëri shumë pak për ta shmangur humbjen dhe greku Giannis Antetokounmpo ishte i vetmi që u përpoq ta çojë skuadrën drejt suksesin, por 31 pikët, 17 rikuperimet dhe 7 asistimet e tij nuk mjaftuan për

ta shmangur humbjen. Mjaft e luftuar ishte edhe përballja në mes të Indiana Pacersit dhe Miami Heatit që, në fund, ky i fundit fitoi me rezultatin final 101-113. Fraksioni i parë dhe i tretë shkuan për Pacersin, ndërsa i dyti dhe i katërti u dominuan nga Heatit, që ia dolën në fund ta marrin suksesin edhe falë një ndeshjeje mjaft të mirë të dyshes Butler - Dragiq. James Hardeni ishte fantastik për Houston Rocketsin, pasi shënoi 37 pikë, rikuperoi 13 topa dhe dha 3 asistime, duke ndihmuar skuadrën e vet të fitojë me rezultatin 123-108 përballë Ocklahoma City Thunderin në sfidën e parë "play off" mes të dy ekipeve. Rocketsi dominoi në tri të katërtën e lojës dhe lëshoi pe vetëm në

fraksionin e fundit, të cilin Ocklahoma e fitoi me shifrat 19-25, por avantazhi i Houstonit ishte i konsiderueshëm dhe ishte e pamundur të ndryshohej fati i takimit. Zhgënjeu në sfidën e parë "play-off" edhe Los Angeles Lakersi, që u mposht nga Portland Trail Blazersit me shifrat 93-100. Që prej rifillimit të kampionatit, skuadra kaliforniane nuk ka treguar një formë të mirë dhe kjo u pa edhe në mbrëmjen e djeshme, ku fitoi vetëm një nga 4 fraksionet e lojës. Dyshja Anthony Davies - LeBron James mbetën në hije përballë sportistit të Portland Trail Blazersit, Damian Lillard, i cili ishte edhe më i miri i ndeshjes me 34 pikë të shënuara, pesë topa të rikuperuar dhe pesë asistime.

SHKURT

Koeman, trajner i ri i Barcelonës

Strategu holandez Ronald Koeman është trajner i ri i Barcelonës. Koeman është zyrtarizuar në drejtim të ekipit katalan në kontratë deri më 30 qershor të vitit 2022. Koeman te Barcelona vjen pas aventurës si selektor i Holandës. Ai do ta zëvendësojë Quique Setien, i shkarkuar pas humbjes 8-2 nga Bayern Munich në çerekfinalen e Ligës së Kampionëve.

Nagelsmann: PSG-ja e meritoi kualifikimin në finale

Trajneri i RB Leipzigut, Julian Nagelsmann, ka deklaruar se PSG-ja e ka merituar kalimin në finale të Ligës së Kampionëve pas fitores me rezultat 3-0. "Tiketë e finales për Parisin është e merituar", ka deklaruar Nagelsmann. "Në minutat e parë të ndeshjes ne bëmë mirë dhe kishim situata të mira. Ishte e vështirë të rikthehemi në ndeshje pas golit të dytë sepse Parisi ka shumë cilësi në skuadër. Është vështirë të pranohet, por ky është futboli", ka shtuar Nagelsmann.

Eto'o: Nëse Messi largohet, Barça duhet ta ndërrojë emrin

Ish-sulmuesi i Barcelonës, Samuel Eto'o, ka thënë se klubi katalan nuk duhet ta lejojë largimin e yllit argjentinas, Lionel Messi. Eto'o mendon se nëse argjentinas vendos të largohet, atëherë klubi duhet ta ndryshojë emrin. "Barcelona është Messi dhe nëse ai vendos të largohet, duhet ta ndryshojmë emrin e klubit. Jemi me fat që është në Barcelonë, kemi lojtarin më të mirë në botë dhe të të gjitha kohëve, duhet të bëjmë çmos që të sigurohemi ta përfundojmë karrierën te Barcelona", ka thënë Eto'o.

Portieri i Romës infektohet me Covid-19

Portieri i Romës, Antonio Mirante, ka konfirmuar në rrjetet sociale se ka rezultuar pozitiv me koronavirus. Portieri konfirmoi se, pavarësisht se ka dalë pozitiv me Covid-19, ndihet mirë. Mirante është asimtomatik dhe është lojtari i parë i prekur nga Covid-19 në Serinë A. "Përhëndetje të gjithëve, siç disa prej jush mund ta dinë, unë kam rezultuar pozitiv me Covid-19. Doja t'ju thosha se jam mirë. Nuk kam simptoma dhe ndihem mirë. Jam izoluar dhe shpresoj që të rikuperohem sa më shpejt dhe të bashkohem me shokët e ekipit. Ju falënderoj për mesazhet që më keni dërguar", përfundon postimi i Mirantes. 37-vjeçari ka luajtur vetëm 5 ndeshje në sezonin 2019-2020 dhe e ka mbajtur portën të paprekur në dy ndeshje.

Di Maria, pas fitores kundër Leipzigit: I kemi 'ngrënë' prej minutës së parë

Ylli i Paris Saint-Germain, Angel Di Maria, e ka lartësuar skuadrën e vet pas fitores bindëse 3:0 kundër RB Leipzigit në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve. Anësori argjentinas bëri paraqitje të mrekullueshme kundër gjermanëve, duke u zgjedhur lojtari më i mirë i ndeshjes, pasi e shënoi një gol dhe i dhuroi dy asistime. Falë paraqitjes së tij, PSG-ja e arriti finalen e Ligës së Kampionëve për herë të parë në histori të klubit. Di Maria u shpreh i lumtur me paraqitjen dhe mezi e pret finalen e së dielës kundër fituesit të duelit tjetër gjysmëfinale mes Bayern Munichit dhe Lyonit. "I kemi ngrënë prej minutës së parë. Do ta kemi të vështirë të bëjmë gjumë nga tani deri në ditën e finales", ka thënë Di Maria për BBC. "Ne punuam shumë gjatë gjithë ndeshjes dhe e dëshmuam se e meritojmë të jemi këtu. Nuk ka rëndësi me kë përballemi, Bayern apo Lyon, do të japim gjithçka nga vetja. Jemi shumë të lumtur. Kjo është finalja e parë për klubin", ka shtuar Di Maria.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

INr. 464-37927
Datë: 19.08.2020

Në bazë të dispozitave të neneve 11,13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 datë 4 Qershor 2008, nenit 4, nenit 7 dhe nenit 8 të Ligji Nr.03/L-139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, dhe me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 datë 28 Tetor 2010, dispozitave të nenit 83 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 datë 25 Maj 2016, nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit INr.110-623 datë 26.09.2008, Vendimit të Kuvendit Komunal Lipjan 15Nr.464-26331 datë 29.06.2020 për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmerive në funksion të ndërtimit të rrugës unazore në Lipjan, Kryetari i Komunës së Lipjanit merr:

VENDIM

I. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat ndikohen nga projekti-riplanifikim i trasesë pjesa që ndërlidhë rrugën ekzistuese "Bajram Gashi", "Sadik Shala" dhe pjesa e segmentit rrugor "Halil Metaj" si fazë e parë implementuese në Lipjan sipas tabelave të përshkruara nga evidenca kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik, si dhe sipërfaqet e tyre të cilat tabela paraqesin pjesët përbërse të këtij vendimi.

II. Vlera e kompensimit të pronës caktohet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës konform Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 Tetor 2010 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 për miratimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit-Sektori Pronësoro-Juridik, Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati i Shërbimeve Publike.

IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe publikimit të tij në njërin nga gazetat me tirazh më të madh.

I'u dërgohet:

- të gjitha Drejtorive
- Arkivit të Komunës

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti



Përshkrimi i detaj i parcelave kadastrale sipas Certifikatës-Njësisë kadastrale për shpronësim për rrugën e re në Lipjan

Nr.	Pronar	Parcela kadastrale	Kultura-klasa	Sipërfaqe m ²	K.K. Lipjan Gjendja e re			
					Pronar	Parcela kadastrale	Kultura-klasa	Sipërfaqe e mbetur m ²
1	Ilir Zeqiri (Rasim)	00637-12 ZK Lipjan	Livadh i kl.1	800	Gjerëtanishmi E re	692	108	
2	Rruzhdi Gashi	00637-9 ZK Lipjan	Livadh i kl.1	370	Komuna e Lipjanit KK Lipjan	Rrugë lokale	15	
3	Rruzhdi Gashi	00671-10 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	80	Gjerëtanishmi E re			80
4	Lumnije Kongjeli (Hali)	00671-11 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	670	Komuna e Lipjanit KK Lipjan	Rrugë lokale	59	
5	Ramiz Bytyqi (Ibrahim)	02082-1 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	400	Gjerëtanishmi E re	378	22	
6	Ramiz Bytyqi (Ibrahim)	02082-2 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	400	Komuna e Lipjanit KK Lipjan	Rrugë lokale	21	
7	Ramiz Bytyqi (Ibrahim)	02082-3 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	400	Gjerëtanishmi E re	379	21	
8	Avni Bytyqi (Ibrahim)	02082-4 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	500	Komuna e Lipjanit KK Lipjan	Rrugë lokale	27	
9	Isuf Bytyqi (Ibrahim)	02082-5 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	500	Gjerëtanishmi E re	473	27	
10	Sami Bytyqi	02082-6 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	400	Komuna e Lipjanit KK Lipjan	Rrugë lokale	22	
11	Ramiz Bytyqi (Ibrahim)	02082-7 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	300	Gjerëtanishmi E re	282	18	
12	Ramiz Bytyqi (Ibrahim)	02082-8 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	400	Komuna e Lipjanit KK Lipjan	Rrugë lokale	25	
13	Suzana Vehapi	00671-9 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	610	Gjerëtanishmi E re	570	40	
14	Fevzi Reçica (Idriz)	00672-2 ZK Lipjan	Arë e kl.3	2471	Komuna e Lipjanit KK Lipjan	Rrugë lokale	39	
15	Hasim Vishesella (Jahir)	00672-3 ZK Lipjan	Arë e kl.3	3272	Gjerëtanishmi E re	3003	269	
16	Fevzi Reçica (Idriz)	00672-4 ZK Lipjan	Arë e kl.3	1529	Komuna e Lipjanit KK Lipjan	Rrugë lokale	122	
17	Sefa Bajrami (Shirë)	00674-2 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	590	Gjerëtanishmi E re	242	348	
18	Xhezair Bajrami (T)	01406-1 ZK Lipjan	Arë e kl.2	1132	Komuna e Lipjanit KK Lipjan	Rrugë lokale	759	

19	Habib Sadiku	01407-2 ZK Lipjan	Arë e kl.2	1971	Komuna e Lipjanit Gjerëtanishmi	KK Lipjan E re	1567	373
20	Habib Sadiku	00440-14 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	1719	Komuna e Lipjanit Gjerëtanishmi	KK Lipjan E re	1386	333
21	Mehdi Bajrami (Hafir)	00442-1 ZK Lipjan	Arë e kl.3	4195	Komuna e Lipjanit Gjerëtanishmi	KK Lipjan E re	2742	1453
22	Tahir Bajrami (Xhemajl)	00459-0 ZK Lipjan	Arë e kl.3	7944	Komuna e Lipjanit Gjerëtanishmi	KK Lipjan E re	6597	1347
23	Ramiz Bytyqi (Ibrahim)	00671-6 ZK Lipjan	Rrugë private	73	Komuna e Lipjanit Gjerëtanishmi	KK Lipjan E re		73
24	Hasim Vishesella (Jahir)	00671-7 ZK Lipjan	Rrugë private	87	Komuna e Lipjanit Gjerëtanishmi	KK Lipjan E re		87
25	Bajram Gashi (Sabit)	00460-6 ZK Lipjan	Rrugë	680	Komuna e Lipjanit Gjerëtanishmi	KK Lipjan E re		680
26	Mejreme Jashanica (Osman)	00460-1 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	500	Komuna e Lipjanit Gjerëtanishmi	KK Lipjan E re	488	12
27	Ilfat Osmani (Ali)	00460-2 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	770	Komuna e Lipjanit Gjerëtanishmi	KK Lipjan E re	724	46
28	Izet Osmai (Ali)	00460-3 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	770	Komuna e Lipjanit Gjerëtanishmi	KK Lipjan E re	725	45
29	Brahim Bytyqi	00460-4 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	600	Komuna e Lipjanit Gjerëtanishmi	KK Lipjan E re	566	34
